



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 121, Nëntor 2013

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Martin Camaj i papërsëritshëm

**JAM PËRMBYTJA
UNË ...!**



Me në fund, ne shqiptarët vendosëm një standard të ri. Unë do ta quaja fitorja e parë e demokracisë në Shqipëri. Tashmë sheshet nuk janë më prona të qeveritarëve, të cilat herë i përdoren për të grumbulluar me hiri e pa hiri mbështetës dhe herë për t'i përgjakur ato duke rrahur, torturuar e vvarë kundërshtarët politik. Kjo është një fitore e vetëdijes qytetare, ndonëse e ardhur shumë vonë, ajo u demonstrua në protestat popullore për kundërshtimin e demontimit të armëve kimike në vendin tonë.

2

Festa Nacionale e Austrisë

Me datën 15 nëntor 2013, ne mjediset e Hotel "Turizmi" u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja dhe Natalja Leqeja si dhe Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Tomas Schnoll me bashkëshorten e tij, Regan Schnoll.

Morën pjesë Presidenti i Miqësisë Shqipëri-Austri, profesor doktor Mahir Hoti, deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore në qytetin e Qarkun Shkodër, Monsinor Angelo Massafro, Mjeshtri Fadil Kraja e personalitete të tjera në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të qytetit tonë.

11

Zona e Shllakut

- DISA VEÇORI -
Përgatiti, Dr. Med. Ndue Nikaj

Shllaku një nga fiset me zë të malësisë për trimni, burri e besë, i treveses së shtruar për mikun (bukë e kripë e zemër të bardhë), i rakisë dhe i qymyrit.

Sipas të dhënave të trashëguara brez pas brezi dhe studimeve, zona e Shllakut dhe e Temal-Dushmanit, ku deri vonë përfshihej dhe Mazrreku me dy fiset e veta (Kçyra dhe Bardhi) bëjnë pjesë në zonën e Dukagjinit, të Rreth-Qarkut Shkodër.

9

NDERIM PËR PUNEN E BËRË NË SHËRMBIM TË KOMUNITETIT DUKAGJINAS

Për Komunën e Shalës po kthehet në traditë vlerësimi i bijve e bijave të saj e më gjerë për punën e bërë në shërbim të Dukagjinit. Pas Prelë Bregut, Prelë Grimës e Ndokë Gjellshit, Këshilli i Komunës Shalë e Kryetari i saj Balë Vuksani në bashkëpunim me Shoqatën "Atdhetare Dukagjini" me 9 Nëntor 2013 organizuan një ceremoni në Bibliotekën e qytetit Shkoder "Marin Barleti" ku nderoi me tituj të veçantë dy persona me kontribut të spikatur në shërbim të Komunitetit e pikërisht shaljanin veteran Luigj Shala me titullin "Nderi i Komunës së Shalës" dhe tiranasin Ismail Beka me titullin "Mirënjohje e Komunës së Shalës". Në këtë ceremoni cilësore – sepse Shoqata "Atdhetare Dukagjini" ju a ka marrë dorën organizimit të veprimtarive të tilla që janë të shumta – morën pjesë dy personazhet, të afërm të tyre, miq, shokë e bashkëpunëtorë, veteran...

3

ZYDI BARBULLUSHI, KUJTIMET E MIJA PËR DODË TAHIRIN

Jam njohur që në vitet e okupacionit, kur Doda erdhi nga Podgorica për të luajtur futboll me "Vllazninë". Nuk më kujtohet fiks data, por e mbaj mend shumë mirë kur erdhi dhe e gjeti ekipin tek po luante ndeshjen stërvitore (*kontrolli*) në dy formacione, ku të dy portat ishin të zëna dhe Doda mbeti i vetëm në xhepa!

Për pak çaste qëndroi duke pa me nervozizëm stërvitjen, pastaj iu drejtua Bimo Fakjes, të cilin me sa dukej ...

10

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION PRODUZIONE GIACCHE



JAM PËRMBYTJA UNË ...!

editorial nga LAZER KODRA



MË NË FUND...

Me në fund, ne shqiptarët vendosëm një standard të ri. Unë do ta quaja fitorja e parë e demokracisë në Shqipëri. Tashmë sheshet nuk janë më prona të qeveritarëve, të cilat herë i përdoren për të grumbulluar me hiri e pa hiri mbështetës dhe herë për t'i përgjakur ato duke rrahur, torturuar e vrarë kundërshtarët politik. Kjo është një fitore e vetëdijes qytetare, ndonëse e ardhur shumë vonë, ajo u demonstrua në protestat popullore për kundërshtimin e demontimit të armëve kimike në vendin tonë. Shqiptarët ishin dëshmitarë dhe pjesëtarë të protestave të lira, sheshet u

zotëruan prej tyre, autoblanda nuk pati, gaz-lotsjellës nuk pati, policia demonstroi fytyrën e vërtetë të shtetit. Njerëzit gëzuan lirinë, për herë të parë në këto 23 vite, ndërsa shteti bëri më të mirën e tij. Edhe skeptikët edhe nihilistët më të thekshëm këtë radhë, ndonëse pas disa përpëlitjeve të turpshme, heshtën. Arsyja kishte triumfuat mbi instinktin dhe barbarinë që ishin bërë "pronare" të këtyre shesheve për shumë vite radhazi. Një epokë e re lindi falë 23 qershorit. Më në fund mund të protestosh i lirë o Njeri!

RETROSPEKTIVA E TMERRIT

Është e dhimbshme po të hedhim një sy në të kaluarën. 2 prill 1992, sheshi mbushet me njerëz. Sheshi përgjaket. Idetë vdesin! Maj 1996, votohet nën dhunë. Partia në pushtet "fiton" 96%! Rekord për librin Guines! Pas dy ditësh protestohet. Sheshi përgjaket. Deputetë e opozitës dhunohen e arrestohen. Demokracia-foshnje sëmuret dhe "vdes" vetëm pak më vonë. Pranverë 97. Çmenduria e pleksur me paaf-

tësinë qeverisëse mashtrojnë një popull të tërë. Kostoja më e lartë se e çdo lufte që zhvillohej ndokund në atë kohë. Mijëra të vrarë. Sheshet u ngjanin pas betejave me shpata. E gjitha kjo për dy prapanica pushteti të asokohe! "Bomba" shpërthen në Gërdec. Ai që drejtonte shtetin pohon se nuk e dinte ku bie Gërdeci! Të vetmen dhimbje ndien për një baxhanak që i paska vdekur aty dhe si për ironi të fatit s'e paska njohur në jetën e gjallë! Njëzet e shtatë viktimat e këtij tmerrit u mbuluan me "pluhur harrese" nga qeveritarët. Demokracia e brishtë shqiptare 'vdiq', përfundimisht me 21 Janar 2011. Sheshi mbushet nga protestuesit. Shteti vret pa pikën e mëshirës dhe arsyes. Diktatura shfaqet në mënyrë atavike. Shpresat e njerëzve veniten, ndaj duhej një rifillim i lindjes demokracisë.

PSE NUK U PROTESTUA NË SHKODËR?

Ishte kënaqësi të shikoje njerëzit në sheshe, kishin apo nuk kishin të drejtë për armët kimike, tek vetorganizoheshin, demonstronin, thirrnin, mbanin pankarta dhe mbi të gjitha tregonin pavarësinë e tyre politike. Kjo ndodhi në

shumë shesh të Shqipërisë. Po në Shkodër a ka shoqëri civile të organizuar? A është kultivuar vetëdija për të protestuar të ndikuar nga vetvetja? Fatkeqësisht jo! Akoma nuk jemi çliruar nga vetvetja. Shikuam një grupim të vogël në një qoshk dhe një person, që nuk ia di emrin, që recitonte rëndom një poezi ku më tepër dëgjoheshin tingujt fundor si: bana-hana-llana e një dreq e di se çfarë! Qartësisht diktohej se nuk kishim të bënim me një protestë civile, por me një lloj mllëfi që personi në fjalë shkruhe kundër nuk e di se kujt ... dhe për konçidencë në këto moment protestuesit e Tiranës dëbonin nga sheshi në mënyrën më të turpshme, por shumë demokratike, ish Kryeministrin dhe soozinë e tij duke ruajtur kështu pastërtinë e një proteste civile. Në një qoshk tjetër një tjetër grupim dhe oratori nuk e ka të qartë përse protestohet, por flet për komunizëm! Ndërkohë, pak dit më parë i mençuri Dashamir Shehi deklaronte: *"Tashmë përdorimi i termave të komunizmit nuk i jep askujt satisfaksion as pikë politike. Ka ardhur koha të konkurrojmë më vlera e ta lëmë të shkuarën të vdesë"*. Atëherë për cilin komunizëm flitet. Ndodh që duke mos e harruar të keqen vjen një kohë e të behët pjesë e pashkëputur e ndërgjegjes. Pse duhet të

ndodhë kjo në Shkodër!?

"ZOTI E BEKOFTË RININË SHQIPTARE!

Njeriu që e ndau jetën e tij ne dy baraslargime, njëherë ithtarë i pafre i tesarës së kuqe për njëzet e gjashtë vite radhazi dhe pastaj për njëzet e tre vite radhazi bubullues e zjarrvënës i fshehur pas fasadës së tesarës blu shkruan në Facebook-un e tij: *"... Zoti e bekoftë rininë shqiptare!"* Çfarë ironie makabre! Idiotësi prej plakjeje të çdo gjëje të tij! A nuk kumbon ky urim si në kohën kur thoshte: *"Rinia është gjaku i ri i partisë!"* A ka vlerë ky urim prej mendjempirim, kur plumbat e tij vranë qindra e mijëra të rinjë në vitin 97, kur plumbat e tij vranë Aleks Nikën, Hekuran Dedën e te tjerë? Dhe pastaj ç'lidhje kishte protesta me politikën dhe aq më tepër me këtë njeri, që fatmirësisht edhe pse shumë vonë, eugenika politike e seleksionoi përfundimisht me 23 qershor si përfaqësuesin e fundit të regjimit të tmerrshëm komunist. Një kohë e re po lind. Duhet bërë kujdes. Mbetje të tilla, si ky 'uruesi' fals përbëjnë rrezik të përhershëm. Populli ka të drejtë të protestojë. Një poet grek e kërcënonte qeverinë duke iu drejtuar me një varg poetik: *"Jam përmbytja unë ...!"*

NDAHET NGA JETA INTELEKYUALI DUKAGJINAS, NDUE NDREZAJ

Pak ditë më parë u nda nga jeta Ndue Gjelojsh Ndrezaj, birë i Vuksanajve të Shalës, bir i Dukagjinit.

Për familjen e tij, të afërmit, shokët e miqtë ishte një dhimbje shumë e madhe që do ti shoqërojnë mjaftë gjatë.

Ai, u nda nga jeta në moshë të re, sapo kishte kaluar të 50-tat, në moshën më të mirë të pjekurisë profesionale dhe shoqërore. U nda nga kjo jetë në atë moshë që kishin shumë nevojë për të bashkëshortja Drandja, fëmijët Kristiani, Klodiana dhe Kladiola, nëna Mrika, vëllezërit dhe motrat, të afërmit, por edhe shokët, miqtë e kolegët e punës, sepse ai dinte të kishte vetëm miq.

Ndue Ndrezaj u lind në Vuk-sanaj, në njërën prej atyre



kullave të Dukagjinit që kanë trashëguar vlerat më të mirë shoqërore dhe morale të krahinës dhe më gjerë.

Ndue Ndrezaj ishte nxënës dhe student shumë i mirë në

shkollë të të gjitha niveleve. Pas mbarimit të shkollës vjeçare në fshatin e lindjes dhe të shkollës së mesme "Mehmet Shpendi" në Breglumi të Shalës, mbaron edhe Universitetin e Tiranë me rezultate shumë të mirë në fakultetin e shkencave të natyrës, në degën biologji-kimi.

Ky djalë në të pamë, por burrë bashkëkohor dhe intelektual në mjedise shoqërore e shtetërore, që shembull i kulturës në marrëdhënie me të gjithë, dashamirës, veprimtarë i përhershëm në të mirë të komunitetit, familjarë dhe prind shembullorë, mësues i përkushtuar në edukimin e brezit të ri, drejtor shkolle me vizion të qartë për të ardhmen, këshilltarë për disa mandatë i Komunës Shalë dhe kryetar

i Këshillit të Komunës për dy mandate, e te tjera.

Ndue Ndrezaj është i ati brezi intelektualësh të Shalës dhe Dukagjinit që me punën e tyre i kanë rritur vlerat krahinës dhe janë shembull për brezat që vinë. Respekti që ka krijuar ky malësor me virtyte shumë të larta njerëzore me familjen dhe të afërmit, shokët e miqtë, të gjithë ata me të cilët punoj dhe jetoj apo u takua, ishtë i madh, do të jetojë gjatë në zemrat e tyre.

Ai nuk ishte vetëm mësues e drejtues shkolle shumë i mirë, por ishte edhe këngëtar e instrumentist me vlera, sportist dhe shahist i pëlqyer në zonë. Ai shumë i këndshëm në shoqëri dhe kishte një humor të hollë dhe të këndshëm.

Profesor Nduja, siç e thërrisnin me të drejtë ish nxënësit, ka qenë dhe mbetet nga njerëzit më të pëlqyer të Shalës dhe Dukagjinit që, do të kujtohet për shumë e shumë kohë.

Ndue Ndrezaj, ishte anetar i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", qe ne themelimin e saj dhe mjaft i përkushtuar ne realizimin e misionit te saj.

Ndue Ndrezaj u përcoll për në

banesën e fundit, para kohe, por jeta kështu e ka. Qindra njerëz e përcollën me nderime e respekt shumë të madh. Komuna Shalë dhe Shoqata "Atdhetare Dukagjini" e nderuan me kurora dhe fjalë të përmortshme.

Vdekja është për të gjithë njerëzit, atë e kemi të pashmangshëm të gjithë, por kur njeriu len prapa emrin e mirë e kujtohet për të mirë është shumë e madhe, për të cilin do të jemi dhe duhet të jemi krenar. I tillë qe dhe mbetet jeta, puna dhe përkushtimi i Ndue Ndrezajt.

Njerëzit e fortë përballonjë dhimbje të forta. Familja dhe të afërmit e Ndue Ndrezajt përballuan, dhe do të përballojnë këtë dhimbje për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur, por jo vetëm të atyre.

Mos u harroftë emri dhe jeta e Ndue Ndrezajt!

Bal Vuksani, Ndue Sanaj, Prekë Doçi, Luigj Shyti, Gjovalin Troja, Prele Milani, Dedë Gjini, Gjon Ftoni, Pal Shytani, Kujtim Marku, Kolë Vladi, Pal Rrathtori, Kolë Vata, Aleks Ndreshaj.

NDERIM PËR PUNEN E BËRË NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT DUKAGJINAS

Për Komunën e Shalës po kthehet në traditë vlerësimi i bijve e bijave të saj e më gjerë për punën e bërë në shërbim të Dukagjinit. Pas Prelë Bregut, Prelë Grimës e Ndokë Gjeloshit, Këshilli i Komunës Shalë e Kryetari i saj Balë Vuksani në bashkëpunim me Shoqatën “Atdhetare Dukagjini” me 9 Nëntor 2013 organizuan një ceremoni në Bibliotekën e qytetit Shkoder “Marin Barleti” ku nderoi me tituj të veçantë dy persona me kontribut të spikatur në shërbim të Komunitetit e pikërisht shaljanin veteran Luigj Shala me titullin “Nderi i Komunës së Shalës” dhe tiranasin Ismail Beka me titullin “Mirënjohje e Komunës së Shalës”. Në këtë ceremoni cilësore – sepse Shoqata “Atdhetare Dukagjini” ju a ka marrë dorën organizimit të veprimtarive të tilla që janë të shumta – morën pjesë dy personazhet, të afërm të tyre, miq, shokë e bashkëpunëtorë, veteran, këshilltarë të Komunës Shalë e Bashkisë Shkodër. Pjesëmarrës special ishin Ministri i Transportit në Qeverinë Rama, z. Edmond Haxhinasto dhe Prefekti i Qarkut Shkoder z. Paulin Radovani.

Se kush është Luigj Shala foli më gjerësisht Kryetari i veteranëve të Rrethit Shkoder, z. Vehbi Fishta i cili ndër të tjera tha: “Luigj Shala për shumë dekada duke filluar nga vitet e para të çlirimit, ka kryer detyra të rëndësishme shoqërore e shtetërore që nga udhëheqës rinie e deri drejtues i ndërmarrjeve nga më të rëndësishmet në qytetin e Shkodrës si ajo ushqimore apo elektroujësjesit i cili është karakterizuar nga aftësia organizative e menaxhuese, është shquar për korrektësinë e vitalitetin në punë duke qënë shumë kërkuar në radhë të parë ndaj vetes pastaj ndaj vartësve duke bërë që kudo që ka shkuar të ketë patur rezultate të larta në punë. Mbas daljes në pension ka qënë një veprimtar shumë aktiv i Organizatës së veteranëve të luftës NAÇL të Rrethit ku që nga viti 1999 deri në Shtator 2013 ka qënë N/kryetar i Komitetit të veteranëve, detyrë që e ndërpreu për arsye shëndetësore. Ka punuar me ndërgjegje të lartë e përkushtim atdhetar për të përmbushur detyrat që Organizata e Veteranëve ka duke qënë shumë aktiv në të gjitha veprimtaritë që veteranët kanë organizuar në të gjitha trojet shqiptare. Gjithë kjo veprimtari është vlerësuar duke i dhënë tituj nderi nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve të luftës NAÇL apo ai i Shkodrës duke e bërë “Nderi i organizatës së veteranëve”. Titulli që po i jepet sot është një vlerë e shtuar në të gjitha vlerësimet që Luigj Shala ka marrë në jetë.

Se kush ishte Ismail Beka i cili u vlerësua nga Komuna Shalë, ja tha auditorit moderatori i kësaj veprimtarie dhe njikohsisht Sekretari i Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” z. Luigj Shyti i cili vijoi: Ismail Beka është i lindur në Tiranë, i diplomuar si inxhinier mekanik në vitin 1978. Për shumë vite ka punuar në Ministrinë e Bujqësisë, në Sektorin e Mekanikës BUJQësore duke drejtuar reforma e ndryshime në këtë sektor. Disa vite ka koordinuar projektet e donatorëve të huaj në Sek-



Luigj Shala, duke përshëndetur me rastin e marrjes se titullit “Nderi i komunës Shale”



Ismail Beka duke përshëndetur, me rastin e marrjes se titullit “Mirënjohja e komunës Shale”



Ministri i Transporteve, Edmond Haxhinasto

torin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Pyjeve. Ai ka marrë pjesë dhe ka drejtuar projekte që lidhen me zhvillimin rural në Shqipëri në bashkëpunim me shoqata të tjera si, FEAD, USAID, OECD, FAO, GIZ. Aktualisht kryen detyrën e drejtorit të GIZ për Shqipërinë. Në zbatim të programit të GIZ-së z. Beka i ka kushtuar vëmendje të vazhdueshme zhvillimit të rajonit të Shqipërisë, në mënyrë të veçantë zhvillimit të turizmit familjar në Theth duke realizuar një program tre-vjeçar duke e shndërruar Thethin në destinacionin turistik kombëtar e ndërkombëtar më të veçantë në Shqipëri. Prandaj me punën e tij ka fituar respektin e komunitetit dhe

po vlerësohet nga pushteti vendor.

Titullin “Nderi i Komunës Shalë” z. Luigj Shala ja dorëzoi Kyetari i Komunës z. Balë Vuksani.

Edhe pse jo mirë me shëndet dhe me shumë vite mbi supe, ngjallën interes për pjesëmarrësit fjalët e ngrohta që z. Luigj Shala ku ndër të tjera vijoi: më ka takue me u dekoru mbi 11 herë, me fol para gjithfarë auditori, por emocione si sot nuk kam pasë dhe kurrë nuk kam vlerësu dekorim sa këtë që po më japin sot bashkë-origjinast e mij. Edhe pse për herë të parë në vendin e origjinës time kam shkuar në vitin 1949, unë kurrë nuk e kam mohuar origjinën përkundrazi jam krenar që jam nga Lekajt e Shalës, Lagja Dednikaj dhe gjithë kohën që kam qënë në drejtim jam përpjekur e ndihmuar atë zonë sidomos në sektorin elektrik dhe çfarëdo që të kem bërë më duket pak

kunu me ta dhe u angazhu se ky vlerësim që më bëni më motivon për të punuar akoma më shumë në të ardhmen në shërbim të këtij komuniteti të mrekullueshëm që jeta të bëhet sa më e begatë atje.

Shumë nga pjesëmarrësit shprehën konsideratën e tyre të larë për punën dhe veprimtarinë e dy figurave për të cilët ishte organizuar ceremonia ku po veçojmë; Ndue Sanaj-Kryetar i Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” ndër të tjera tha: Kjo ceremoni ku Këshilli i Komunës Shalë nderon veteranin Luigj Shala dhe drejtuesin e GIZ-se Ismail Beka shënon një risi të re, risinë e vijimit të bashkëpunimit të SHOQATËS tonë me Komunitat e Dukagjinit i cili do të vijojë edhe në të ardhmen në një nivel më të lartë bashkëpunimi. Shoqata “Atdhetare Dukagjini” dhe në përgjithsi komuniteti dukagjinas kanë bërë përpjekje që të vlerësojë e të nderojë figurat e zonës që i kanë dhënë jo vetëm zonës por edhe shqiptarisë, që deri dje kanë qënë të persekutuar apo lënë në hije. Kjo përpjekje n aka dhënë më shumë autoritet e përkrahje. Kjo punë do të vijojë edhe në të ardhmen pork a ardhur koha që të vlerësohen dhe të nderohen edhe ato personalitete që kanë punuar edhe në 5 dekadat e Monizmit sepse punuan e sakrifkuan vetëm për idealin e atdheut. Prandaj duke qënduar larg politizimit, ne duhet të ecim me guxim në këtë drejtim, më e një bashkëpunim më të mirë me Komunitat e zonës>.

Me interes për të pranishmit ishin fjalët e ngrohta të Ministrit të Transportit z. Edmond Haxhinasto i cili tha: <E ndjej veten të privilegjuar që ndodhem midis jush ku do flas jo si anëtar qeverie por si gjaku e nipi juaj (nipi i Luigj Shalës). E kam për nder e jam krenar që kam gjak dukagjinas nga nëna. Që në rininë time kam pasë si model dajën Luigj e vazhdoj ta kem për korrektesën në punë e sjelljen në jetë e shoqëri sepse tek Ai kanë qënë të harmonizuara vetitë e virtytet më të mira të malsorit me edukatën qytetare të Shkodrës. Ju siguroj se do ti shkrij mundësitë e mija për ta ndihmuar atë zonë. E siguroj dajën Luigj se, jo vetëm që do ti kryejmë ato gjëra që I kanë mbetë merak por edhe shumë të tjera prandaj të rrijnë i qetë...>.

Prof.ass.dr. Zef Gjeta foli si koleg e bashkëpunëtor i Ismail Bekës duke dhënë vlerësimet më të larta për punën e tij kudo ku ka punuar në dikaster apo në bazë, sidomos për zonat malore dhe shpreh optimizmin se do të na ndihmojnë akoma më shumë në të ardhmen sidomos në zhvillimin e turizmit malor. Këtë veprimtari e pasqyruan gjerësisht edhe të gjitha mediat lokale .

Siç është bërë traditë, në fund u shtua një Koktejl shumë cilësor ku, deputeti Tom Doshi mori falenderimet më të mira për mundësimin e tij. Kjo ceremoni u mbyll me urimin: mirupafshim në veprimtari të tjera.

Mundësoi këtë veprimtari deputeti Tom Doshi.

Prele Shytani

FADIL KRAJA EMBLEMA E QYTETIT TË SHKODRËS

VEPRA E PROF. FADIL KRAJËS DO TË MBETET NË FONDIN E ARTË TË DRAMATURGJISË SHQIPTARE

Nga **RAMAZAN ÇEKA**
Poet popullor

Është periudha e viteve 1930, kur Shqipëria karakterizohej si një vend i prapambetur dhe i varfër, i dalë me mundim nga errësira pesëshkullore e pushtimit otoman, por me një trashëgimi tradicionale kulturore që ndriçonte me dritën iluministe të Rilindjes Kombëtare duke krijuar vatra përparimi, sidomos në qytetet kryesore të vendit si: Shkodra, Tirana, Elbasani, Korça, Gjirokastra etj. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe që në djepin e nënës shkodrane që përkundej pranë një vatre të tillë plot dritë e ngrohtësi, të mos lindnin edhe djem e vajza të talentuar që do ta mbanin gjallë këtë zjarr me veprat e tyre. Në një vatër të tillë shkodrane ku kultura dhe arsimi ishin ushqimi i përditshëm, lindi në vitin 1931 edhe shkrimtari me një krijimtari të shumanëshme e cilësore dhe me vlera mbarëkombëtare, veçanërisht në fushën e dramaturgjisë, Fadil Kraja. Mësimet e para për historinë, për gjuhën e bukur shqipe, për zakonet dhe traditat e bukura shqiptare, Fadili i mori që në prehërin e nënës së tij, mësueses së paharruar Hajrie Hanëmi (Zonja Hajrie), e cila ka qenë e vetmja grua e asaj kohe që ka ditur t'i bie instrumentit

shumë të vjetër "UDI" që kishte 12 tela dhe ishte i vështirë në akordim (Shprehet kështu) petagogu prof. Ferid Bala.

Mbasi mbaroi gjimnazin e Shkodrës, ku

fusha të ndryshme e në mënyrë të veçantë, në fushën e letërsisë dhe të artit.

Fadil Kraja ka luajtur një rol të madh në gjallërimin e Gjmnazit të Shkodrës. Më pas punoi si pedagog i letërsisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi". Për disa dekada drejtoi degën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për Shkodrën, ku nuk e ka kursyer asnjëherë punën e tij duke i dhënë një ndihmesë të madhe edhe dramaturgëve të rinj.

Për disa kohë ka drejtuar Klubin e rinisë dhe më vonë anëtar i përhershëm i këshillit artistik në Teatrin "Migjeni".

Profesor Hasan Lekaj ndër të tjera thotë: "Fadil Kraja është veprimtar i palodhur i shoqatës atdhetare e kulturore "Kosova". Për arritjet në fushën e krijimtarisë letrare, shoqërore e kulturore, vlerësohet me çmime kombëtare të shkallëve më të larta. Jeton, punon e krijon me ritëm djaloshtar në Shkodër.

Përmbledhja poetike "Hije të paska" përfaqëson krijimet më të mira poetike të autorit në një hark kohor 50-vjeçar. Riballafaqimi me lexuesin është kujtesë dhe vlerë që, jo vetëm na kujton poetin e kohës së tij me detaj funksional, ritëm, muzikalitet e komunikim që përcjell mesazhe të ndërsjellta por edhe ritregon vlerat e një përvojë poetike që,



spikati talenti i tij për letërsinë, u diplomua në Universitetin e Tiranës në fakultetin e filologjisë gjuhë-letërsi, dhe vazhdoi me pasion profesionin e mësuesit të cilin e trashëgonte dhe nga familja e tij. Ai kontribuoi për vite me radhë si një mësues i nderuar në fshat e qytet duke nxjerrë nga duart e tij nxënës e studentë që kanë shkëlqyer në

pavarësisht tradicionalitetit, di të shpalosë me art mbresa qytetarie edhe në bashkëkohësinë tonë trazuese".

Fillimet e para në krijimtari datojnë që në moshë të re. Vëllimi i parë poetik "Kanga ima" (1954) fitoi çmimin e parë në Konkursin Kombëtar të Letërsisë. Pastaj me radhë ka botuar vëllimet poetike "Melodi malësore", "Jehona malesh" etj., vëllimet me tregime "Kandidatja e fundit", "Ndodhitë e Nereidës", romanet: "Britma e një gruaje", "Pengu i diellit", "Balada e nënës". E veçanta e romanit "Balada e nënës" është se balada sa e lashtë, aq e re, shprehur nga goja e nënës, është shkruar sa dridhshëm, aq fuqishëm me dorën e birit artist.

Është autor i mbi 50 dramave dhe komedive të shfaqura në të gjithë teatrot profesioniste të Shqipërisë si dhe në Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni dhe në diasporë, ku mund të veçojmë: "Fisheku në pajë", "Baca i Gjetajve", "Gjaku i Arbërit", "Djem të mbarë", "Çështja e Blertës", "Flamur në dasëm", "Rozafa", "Luani i shtëpisë", "Mos më shkim hisen e diellit", "Jorgani", "Ditari i një mësuesi", "Dopio gjash-ta", si dhe shumë drama për fëmijë, librete operash dhe operetash.

Fadil Kraja është fitues i dhjetra çmimeve në konkurse kombëtare. Është Laureat i Çmimit të Republikës, duke u bërë kështu një shkrimtar që ka ndërtuar identitetin e tij shumë planesh.

Eksperienca e tij e gjatë, kontributi i shquar, sidomos në fushën e dramaturgjisë ishin një shtysë për ta nderuar atë si një mjeshtër të madh të fjalës nga institucioni më i lartë, si Presidenti i Republikës i cili i akordoi titullin "Mjeshtër i madh", që vinte mbas vlersimit të madh që i bënte

Seminari "Hoti në rrjedhat e shekujve"

Me datën 23-24 nëntor 2013, ne Miçigan te SHBA, u zhvillua seminari historiko-shkencor, me teme "Hoti ne rrjedhat e shekujve".

Me një salle të mbushur me shqiptar me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo vetëm hotjane për krahinën, e të cilëve bëhej simpoziumi, por edhe nga të gjitha viset e tjera shqiptare. Përfaqësues të shoqatës "Malësia e Madhe"; Pan-federatës "Vatra" dega në Miçigan; shoqatës "Kastrati"; shoqatës "Kosova"; shoqatës "Mirdita" në Amerike; shoqatës "Dukagjini"; Institutit te Studimeve Shqiptaro Amerikane, me qendër në Detroit; shoqatës kulturore "Kelmendi"; te të katër besimeve fetare nder shqiptar në Miçigan; klerikët katolik: Dom Ndue Gjergji, Dom Fran Kolaj e Dom Fred Kalaj; Mediat shqiptare: Televizioni i Shqiptareve të Amerikës, ACTV-televizion Michigan, Platforma televizive AlbaVizion, TV AlbDreams, revista "Kuvendi" e revista "AlbDreams"; intelektual, biznesmen, të të gjitha moshave dhe gjinive.

Ne këtë seminar ligjëruan:

Dr. Edmond Malaj, me teme: "Te dhanë mbi krahinën e Hotit ne Mesjete":

Dr. Ksenofon Krisafi, me teme: "Hoti në forumet e diplomacisë evropiane"

Dr. Rokin Daberdaku, me teme: "Hoti para okupimit turk të shek XIV"

Dr. Frasher Demaj, me teme: "Dhuna dhe terrori ndaj shqiptarëve në krahinën e Hotit 1875-1924"

Dr. Marenglen Verli, Akademik i asocuar, me teme: "Roli i Hotit ne Kryengritjen e Malësisë së Madhe sipas dokumentacionit diplomatik evropian"

Dr. Simon Lufi, me teme: "Lufta e Koplikut dhe kontributi i hotjanëve"

Dr. Izber Hoti, me teme: "Zhvendosja

Mr. Marjan Lulgjuraj, me teme: "Vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Hotit"

Shkrimtari Nikolla Spathari, me teme: "Hoti-Kreu i Malësisë së Madhe në shekuj"

Dr. Angjell Gojçaj, me teme: "Natyra juridike e sovraniteteve shtetërore mbi

Koço Danaj, me teme: "Konferenca e Londrës dhe çështja e kufijve"

Dr. Tomi Treska, me teme: "Rroli i Hotit në historinë e Malësisë së Madhe dhe të Shqipërisë dhe shpërnguljet, si pasojë e rezistencës"

Dr. Sonila BOÇI, me teme: "Bashkëpunimi ndërmjet PKSH dhe PKJ dhe ndikimi i tij në situatën e popullsisë shqiptare në Mal të Zi: rasti i Hotit (1944-1945)"

Publicisti Ndue Bacaj, me teme: "Kontributi i Hotit në roje të kufijve të Shqipërisë etnike gjatë viteve 1939-1945 ..."

Nikollë Camaj, me teme: "Hoti në objektivin e udhërrëfyesve të huaja"

Dr. Dom Nikë Ukgjini, me teme: "Kisha e Hotit për Zot, Atme e Përp-arim"

Dr. Gjovalin Shkurtaç, me teme: "E folmja e Hotit dhe vlerat e saj dialektologjike dhe etnolinguistike"

Dr. Anton Kola Berishaj, me teme: "Veçoritë socio-kulturore të organizimit dhe strukturimit të fisit Hot"

Dr. Palokë Berishaj, me teme: "Shkollat dhe arsimi në Malin e Hotit, 1893-2013"

Mr. Anton Rr. Lulgjuraj, me teme: "Shenja të qytetërimit të lashtë në Hot dhe objektet e kultit"

Përgëzojmë organizatoret e këtij seminari shkencor, për një nga krahina më në zë, me kontribute të mëdha në themelet e shqiptarisë në shekuj!

Redaksia



dhe vendosja e hotjanëve në Kosovë në diakroni dhe në sinkroni"

Dr. Mahir Hoti, me teme: "Vështrim fiziko-gjeografike dhe socio-ekonomik i Hotit"

Akademik KOLEC TOPALLI, me teme: "Thesaret gjuhësore të së folmes së Hotit në një fjalor etimologjik"

territorin e Hotit"

Mr. Pandeli Koçi, me teme: "Mali i Hotit në Letërsinë shqipe"

Mark Junça, me teme: "Kontributi i Hotit dhënë besëlidhjes",

Dr. Romeo Gurakuqi, me teme: "Hoti, kontributi në Rilindje, pavarësi dhe shtetformim 1880-1914"

Mjeshtri i madh, Gjoshho Vasia, u nda nga jeta

Nga, Luigj Shkodrani

U nda një mik i imi i mire nga jeta i madhi dhe i paharruari Gjoshho Vasia, një humorist i pazëvendësueshëm. Unë u rrita me humorin e respektin e tij, sepse ishte një shok e mik i mire i babait tim. Gjoshho ishte i pranishmen ne festa familjare, tek njerëzit e afërm te mijë dhe se bashku me Gjok Vata, bënë një dasme qe i kishte te radha shoqet. Isha i vogël kur merrja pjese ne këto gëzime. Asokohe nuk kishim televizorë dhe me gëzim prisnim se kur do mblidheshim tek një kushëri i babait. Ai ishte gëzimi me i madh i imi ,sepse do te dëgjoja bejtet nga Gjoshhoja e Gjoka. Ku ishin këta te dy nuk qeshej por “qahej ” nga gazi i madh qe behej. Por ja qe jeta ecën me ritmin e vet dhe nuk ka te ndalur,as për këta njerëz te mëdhenj. Nga Gjoshho kam marre shume këshilla për jetën,sepse me respektonte shume dhe me ka takuar te rreme shume se bashku ne aktivitetet qe zhvillonte aso kohe

qyteti i Shkodrës me grupet amatore. Gjoshhoja kishte një grup te Uzinës se telave elektrike, ku ai përgatiste humor për konkurrimet e grupeve te estradave te qytetit. Ishte njeri i jashtëza-

Një karajfile për ty Gjoshho ,ne pamundësi te vij ne varrimin tënd! Një karafil, sepse Ti mbetesh një karajfile midis karafilave te shumte qe ka qyteti ynë, Shkodër Locja ime dhe e jotja



Mjeshtri Gjoshho vasia me këngëtarin Frederik Ndoci

konshëm. Humbja i tij është një humbje e madhe për humorin shkodran dhe atë ne përgjithësi. Ai do mbetesh ne zemrat tona me ato bejtet e tua te famshme qe do te kujtojmë përherë.

Gjoshho qe sot te përcjellin Ty, për ne banesën e fundit!

I përjetshëm qofte kujtimi i tij! Pushoftë ne paqe!

Lamtumire i dashur miku im Gjoshho Vasia!

i dha jetë krijimeve të tij falë bashkëpunimit me një trupë aktorësh virtuozë siç ishte trupa e teatrit të Shkodrës.

Fadil Kraja është një nga penat më të ndritura të dramaturgjisë tonë kombëtare. Askush më mirë se miku dhe bashkëpunëtori i tij më i mirë, regjisori Serafin Fanko nuk mund të bënte një përmbledhje të asaj që solli bashkëpunimi i tij me Fadil Krajen. Të dy i bashkoi puna, gëzimet dhe emocionet, përkushtimet dhe suksestet e skenës. Drama e parë që vuri në skenë pas studimeve, regjisori Serafin Fanko ishte “Fisheku në pajë” që i garantoi një sukses të madh të dyve.”

Fadil Kraja i dha skenës shqiptare vepra të mrekullueshme të interpretuara nga Ndreke Luca, Tinka Kurti, Ndreke Prela, Lec Bushati, Vitor Nino, Bep Shiroka, Ymer Bala, Elez Kadrija, Rikard Ljarja, Bruno Shllaku, si dhe shumë aktorë të trupave profesioniste të Tiranës, Korçës, Elbasanit, Fierit, Vlorës dhe trupës prestigjioze të Prishtinës. Zelli dhe emocion i poetit do të transmetohen tashmë në drama.

Serafin Fanko ka treguar: “Më kujtohet premiera “Baca i Gjetajve”. Jepej me 16 prill 1979 të nesërmen e tërmetit të madh. Salla e Teatrit “Migjeni” ishte e tejmbushur. Në mes të shfaqjes ndodhi një lëkundje e vogël tërmeti. As spektatorët, as aktorët nuk u kujtuan për të. Përkundrazi çdo gjë vazhdoi e qetë. E dhamë atë dramë në 27 qytete shqiptare dhe një vit më vonë në Gjakovë. Salla atje ushtonte nga thirrjet. Në Preshevë një plak i ndezur nga batutat e Fadil Krajes të interpretuara nga i madhi

Ndreke Luca doli në skenë dhe i vuri qeleshen e ti aktorit. Ndreka e mbajti atë qeleshe dhe atë ditë tha “Dua të varrosem me këtë qeleshe”. Amnieti u mbajt.

Në skenë Fadil Kraja ka krijuar me qindra personazhe. Por nuk janë vetëm dramat pjesë e vetme e krijimtarisë të Fadil Krajes. Ai është edhe tregimtar. “Kandidatja e fundit” dhe “Heshtje që të ther shpirtin”, janë dy prej vëllimeve me tregime të tij ndërsa e provoi penën e tij edhe në gjininë e romanit. “Britma e një gruaje” dhe “Zemra e një nëne”, që janë vlerësuar shumë nga kritika. Po kështu Fadil Kraja shkruan dhe boton me sukses në gjuhën italiane veprat “Laquela ferita” dhe “La gravidanza derita” të botuara në Romë dhe në Firenze.

Vepra e prof. Fadil Krajes do të mbetet në fondin e artë të dramaturgjisë shqiptare. Drama e tij e fundit “Dy jetë” tregoi se penda dhe mendja e këtij artisti të shquar, janë të mprehta edhe në këtë moshë, të cilat tregojnë se krijimtaria e Fadil Krajes është vitale dhe e pashtrrshme.

Tavolina e Fadilit tek lokali i njohur si “Tullat e kuqe” në qendër të qytetit të Shkodrës, është kthyer tani gati në proverbiale. Në këtë tavolinë, që në të vërtetë nuk është rrumbullake, ka vend për të gjithë. Aty ulen mësues, pensionistë, shkrimtarë, artistë e piktorë, qytetarë të thjeshtë, nxënës dhe studentë, rapsod popullorë, inxhinierë e politikanë, sportistë e humoristë, të cilët e bëjnë këtë tavolinë katrore, një sofër të madhe ku të gjithë rrinë të barabartë si në tavolinën e famshme të mbretit Artur.

GJOSHO VASIJA

nga Ndue LAZRI

Kush nuk e mban mend humoristin elegant shkodran, parodistin e kupletistin e mrekullueshëm me kitarrë, imituesin e jashtëzakonshëm të disa zërave brenda të njëjtit kuplet, Gjoshho Vasinë? Për shumë e shumë vite ai ishte ndër komikët më të preferuar në skenën e estradës e në ekranin e televizorit shqiptar, për ato aftësi origjinale që e bënë të pangjashëm me asnjë komik e humorist tjetër.

I perskutuar që në vitet e para të rinisë së tij dhe i internuar në kampin famëkeq të Tepelenës, atij ju desh të mbijetonte në luftë të heshtur por të pandërprerë me diktaturën.Sepse, përveç “njollës” në biografi, ai kishte edhe atë eshkën përherë të ndezur në gjirin e tij, humorin e mprehtë e satirën e hollë që në çdo kohë mund të ndiznin zemrat e publikut. E diktatura e dinte që ajo eshkë mund të ndizte zjarr të madh, ndaj e mbante nën survejim të përhershëm, ja kufizonte deri në minimum mundësinë e skenës e të ekranit,por nga ana tjetër nuk mund ta bojkotonin tërësisht, sepse publiku e donte, edëshironte,e kërkonte praninë e tij, e duartrokiste. E çuan në fabrikën ecigareve në Shkodër e ai diti të ngrejë grupin më të mirë të estradave amatore në vend, duke konkuruar edhe me estradat profesionale.

Suksesi i tij nuk u pëlqente sigurimsave, ndaj e transferuan punëtor në hidrocentralin e Vaut të Dejës. Por, i persekutuari që nuk e hiqte buzëqeshjen nga buza se shpirti idonte gaz, komiku, shkrimtari, kompozitori e regjisori që ishin bashkërisht në personalitetin e Gjoshho Vasisë, spikatën edhe atje.E ngriti grupin e estrades me te njohur, qe mori fame ne te gjithë vndin dhe kerkohej nga te gjitha skenat e Shqiperise. Madje ne nje festival nacional te estradave profesionale, grupin e tij amator e futen te konkuronte me ato grupe qe skenen e kishin profesionin e tyre, punen e tyre te perdritshme. Por Gjoshho Vasijs, diti te ndertoje nje shfaqje fine, te bukur e moderne, me humor te holle e te kendshem, aq sa triumfoi mbi profosionistet dhe juria nuk kishte nga t’ja mbante dhe i dha vendin e nderit. Per grupin e Gjoshos, nuk ishte asnjehere problem shtija e biletave, perkundrazi ishte problem se salla nuk kishte vende te mjaftueshme as ne kembe per te futur tere publikun qe ishte gati ta blinte biletën edhe me dufishin e saj. Gjoshi, ne lartesine e 80 viteve moshe, qe per fat te mire as i tregon prej me se 20 vjet jeton ne azil politik ne Itali. Fale internetit, pata fatin e kenaqesine te lidhem me te. Ai me ka derguar nje tufe krijimesh, nga te cilat po zgjedh disa per t’ia paraqitur lexuesit.

Krijimet e Mjeshtrit te Madh, Gjoshho Vasijs, jane shkruar ne gegnisht, ne shkodranishten e embel, qe i ka dhene suksesin ne skene e ne komunikimin me njerëzit.



Martin Camaj i papërsëritshëm

Ditën e shtunë me datë 2 nëntor 2013 në orën 11:00 në sallën e Rektoratit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës u prezantua premiera e dokumentarit mbi një prej shkrimtarëve dhe albanologeve më në zë të mërgatës shqiptare, në gjysmën e dytë të shekullit të XX, poetin shumë të dashur e të mirënjohur, për të gjithë Shqipërinë e shqiptarët, e sidomos atë të veriut të Shqipërisë, Martin Camaj.

Ky aktivitet u organizua në sajë të bashkëpunimit mes Radio Televizionit Shqiptar, Drejtorisë së Programeve Satelitore, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”. Të pranishëm në këtë event ishin zyrtarë dhe figura të njohura politike të qytetit të Shkodrës ...

Nuk kishte se si të mungonte edhe gruaja e shkrimtarit të njohur me origjinë nga Temali I Dukagjinit, Znj. Erika Camaj. Interesi për këtë aktivitet u pa edhe në praninë e mësuesve, pedagogëve kryesisht atyre të profilin shoqëror të degës së Gjuhë-Letërsisë, gazetares të televizioneve lokale dhe vendore, tek studentet e deri tek njerëzit e thjeshtë të cilët siç dukej e kishin mirëpritur këtë premierë dokumentari, si diçka të merituar ndaj kësaj figure të letërsisë e historisë shqipe, autorit të shumë e shumë veprave me vlerë të çmuar e pazëvendësueshme për letërsinë shqiptare si; “Një fyell ndër male”, “Kënga e Vërrinit”, “Djella”, “Njeriu me vete e me të tjerë” etj.

Për sa i përket dokumentarit ishte një realizim i mrekullueshëm i përgatitur me një skenar të jashtëzakonshëm nën punën e palodhur gazetares së mirënjohur; Znj Tefta Radi.

Këtë dokumentar të pranishmit e shoqëruan me shumë emocione e kureshtje duke pasur mundësi të njiheshin me jetën e veprën e Camajt, me fazat më të rëndësishme të jetës së tij, me vendet ku ka jetuar, me jetën bashkëshortore të tij, me karakterin e miqësor e bashkëpunues të tij në lidhje me njerëzit e ambientin që e rrethonte..., pamë edhe rrëfimin emocionues të bashkëshortes së tij me origjinë gjermane Znj Erika Camaj, me dashurinë që shfaq e mënyrën emocionuese teksa tregon për njeriun e saj të jetës. Ishin këto momente që tërhiqnin vëmendjen e pafundme, kureshtjen që dukej e palodhur tek të pranishmit.

Patëm mundësi të njiheshim më mirë me muzën frymëzuese në veprat e Camës. Ku qartësisht në veprat e Martin Camës, u shqua malli për atdheun, mungesa e vatrës së lindjes, së rrënjës së të parëve të tij, ku mori edukimin e parë dhe dashurinë për atdheun, të cilat kanë edhe rolin kryesor duke pasur ndikim të dukshëm. Ky mall i pashuar, kjo mungesë e atdheut e vendlindjes që nuk mund ta shohë e ta ndiejë, e ndjek atë në çdo hap të jetës e veprimtarisë së tij.

I veçantë në këtë aktivitet mbetet edhe momenti i interpretimit emocionues të poezisë së Camës nga aktorët



Ideatorja e skenarit Tefta Radi, duke bere prezantimin e dokumentarit “Martin Camaj i papërsëritshëm”



Av. Bardhyl Lohja, kryetari i Keshillit të Bashkise Shkoder, duke i dorëzuar titullin “Qytetar Nderi” i qytetit Shkoder, për Albanologun Martin Camaj, bashkeshortes se tij, dr. Erika Camaj



Nderi i Kombit, Tinka Kurti dhe Mjeshtërja Roza Xhuxha, me djem e vajza dukagjiane

e mirënjohur: Roza Anagnosti (Xhuxha), Gjon Kola.

Ky ishte një aktivitet i kushtuar këtij njeriu që i dha shumë Shqipërisë e shqiptareve, që na bënë të ndihemi krenar, duke ngritur lart Malësinë e Veriut. Para nesh kjo veprimtari për këtë punë të madhe e të arrirë të malësorit tonë paraqitet si diçka mjeshtërisht e realizuar nga grupi i punës, nën kujdesin e së madhes Znj Tefta Radi, të bashkëpunimit të konsulentit Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, të kamerës me Z. Agim Kuri në krye, me montazhin mjaft të realizuar nga Gjergji Pano, formulimin muzikor që shoqëroi dokumentarin të Znj. Kozeta Rafti dhe miksozhit nga Z. Ermal Bardhi.

Edhe pse Camaj nuk la një trashëgimtar, vepra e tij do jetë ajo që do trashëgohet brez pas brezi si një, pasuri e madhe me vlera të jashtëzakonshme për artin shqiptar në përgjithësi dhe për letërsinë shqipe në veçanti.

Në përfundim të dokumentarit tërheqën vëmendjen duartrokitjet e pareshura të audiencës, të të pranishmëve të cilët e shoqëruan këtë realizim dokumentar me shumë emocione e mirëpritje të lartë. Një organizim e bashkëpunim i tillë padyshim i përket një niveli të lartë.

Pas përfundimit të aktivitetit i ishte lënë hapësira edhe kokteilit vëllazëror mes të pranishmëve, në këtë mundësi bashkimi që ua ofroi ky event i rëndësishëm me qendër të madhin e të pavdekshmin ndër ne, Martin Camaj.

Mundësoi këtë veprimtari biznesmeni Mhill Prioni dhe Pëllumb Shqau.

Daniela Pjetri

CAMAJ ... VLERË QË DUHET RUAJTUR



Nga Lazer Kodra

Një filozof evropian është shprehur: “Varfëria e intelektualëve është pasuria e një kombi” dhe për të vazhduar më tej, intelektualët janë paja e tij. Një komb, që e merr vesh me shumë vonesë se ku i ka vlerat identifikuese, nuk ka se ç’jetë tjetër përveçse një komb fatkeq! Luti Zotin që kjo të mos ndodhë ma! Martin Camaj është pjesë, ndoshta më e çmuara, e rezervatit gjeni dukagjinas, nga ku dolën përmasat e vlerave kombëtare. Drita e diellit depërton edhe në humnera, edhe në ahishtën e ngjeshur, edhe në shpellat e miteve e legjendave veriore e prej aty lastarët e identiteve më të thella kombëtare hedhin shtatin e përvijojnë lavdinë e një kombi. I tillë ishte edhe Martin Camaj, i cili shprehej haptazi: Dheu im asht i përmendur për humnera të thella. Martin Camaj nuk ishte pjesë as produkt i fatalitetit antik, por produkt lartësor i një hullije të gjatë në lëvrimin e tokës së artit e kulturës. Filozofi Monteskje pyetjes: Kush jeni ju?-iu pat përgjigje :Unë jam NJERI, rastësisht kam lindur në Francë. Vërtetë se Camaj lindi në Temal të Dukagjinit, e për këtë nuk mund të jetë askush ma krenar se ne, por tashmë Camaj i përket një dimensionit kulturor që nuk e mbulon më as petku kombëtar.

Albanologu Martin Camaj

Shkëndijimet e para të shpirtit xixëllojnë gaca në sytë e njeriut, e ndoshta kjo ishte arsyeja se përse Patër David Pepa e mori Martinin nga Temali dhe e shkolloi në Kolegjin Saverin në Shkodër.

Camaj ishte Ai që hapi shkollën e parë në Prekal në vitin 1946. Camaj ishte Ai që në vitin 1948, me riskun e vdekjes në gj, mësyni Jugosllavinë. Kështu ai gdhend, tërheq e plugon me “pamendën” e tij, tokën e artit e kulturës shqiptare si një zog vetmitar si një kondor i vetmuar siç shprehet Lisle.

Në vitin 1955 diplomohet në Universitetin e Beogradit për Letërsi të përgjithshme; Letërsi të krahasuar dhe Teori letërsie. Në mbrojtjen e diplomës bashkë me të njohurin Safet Hoxha dhe shkrimtarin e madh serb Danillo Kish vlerësohen me maksimumin e pikëve. Në këtë UT duhet pranuar se u gatua një pjesë e mirë e trurit shqiptar si: Zenel Ajdinoviç, Ramiz Sadikoviç, Dervish Rozhaja, Idriz Ajeti, Esat Mekuli, Musli Mulliqi, Gjeloš Gjoka, Mark e Gjergj Kaçinari, Kristo Lekaj, Bekim Femi, Enver Petrovci, Ekrem Krueziu e shumë të tjerë. Kjo është arsyeja se përse unë jam mbështetës i Akademikut Kapllan Resuli kur shprehet se disa shkrimtarë asokohe banë çmos për të instaluar në mendjet tona një urrejtje pandemike ndaj fqinjëve.

Hoze Valente, një poet spanjoll shprehej: Shkruaj poezi, sepse arti poetik më çel një rrugë depërtimi, që e quaj të pazëvendësueshme, drejt realitetit”- në mënyrë hipotetike unë mendoj se kjo devizë e udhëhoqi Camajn drejt këtij arti gjenial. Në veprën e tij Camaj iu kundërvu kornizës së “realizmit socialist” nëpërmes kundërrymës, pa u kacafytur me të deri në gjakosje. Ai kundërshtonte idenë se poeti nuk ka të drejtë të fyejë epokën e vet, këtu le të kujtojmë edhe Konicën e “Doktor gjilpërës” apo më thellë Bodlerin kur i drejtohej Parist: Të dua o qyteti im i ndyrë!”, po kështu Camaj, i ndikuar nga Gide e Prusti, u ngrit kundër të ashtuquajturit moral “qytetar”, i cili kufizonte lirinë e individit në funksion të dogmës, ishte kundër thyesës stampë, ku numëruesi ishte Atdheu në infinit dhe emëruesi ishte njeriu i petëzuar.

Tek veçantitë tekstore të Camajt do të përmend ato që studiuesi e poeti Koçi Petriti evidenton në punimin e tij të Doktoraturës:

1-Lëvizja ritmike drejt një shkallëzimi zbritës degradues.

2- Camaj, dukuritë i vështron e percepton ritmikisht sipas shkallëzimit zbritës degradues në marrëdhënie ballafaqimi,

kundërvënieje dhe kundërshtimi nëpërmjet një dikotomie të detajeve, metaforave, simboleve, personazheve dhe ambienteve, që në rrjedhën e rrëfimit procedojnë nga njësimi drejt asgjësimit.

3- Krijimtaria e Camajt ka evoluar



përgjithësisht nga ritmi në aritmi në poezi dhe nga aritmia në ritmi në prozën poetike.

Unë mendoj se Camaj përdorë me efikasitet të pasqyruar kuptimin rrethor të fjalës, fuqinë që ka ajo për t’na përfutur imazh që veç ai diti ta vendosë në kontekstin e duhur, harmonizimi i trajtave poetike në funksione kapilare të veprës së tij, pesha neto e leksemës në rrafshin sintaksor, rendja pas përmbajtjes në shërbim të domethënies, shkalla e thellë refleksive e “bluarjes” së realiteteve dhe konvertimi i tij në poezi si dhe përdorimi i një gegnishtje që mund të ketë të krahasuar vetëm me Pater Zef Pëllumbin. Është për t’u përmendur edhe një fakt shumë domethënës: I larguar nga vendi i tij që në moshën 23-vjeçare, ai arriti që “eksportoj bashkë me veten” nga vendi i tij mitet, legjendat, gojëdhënat, bjeshkën, vrrinin, shpellat, lumin, gjarprin, mentalitetin, kulturën dhe të gjitha këto i shërbyen atij si pasaportë shqiptare dhe motive identitare në krijimtarinë e tij të gjerë.

Po sikur Camaj të qëndronte të Shqipëri kush do të kishte qenë?- Kësaj pyetjeje është e vështirë për t’i dhënë

përgjigje, pasi atëherë do pyesim : Po Dantja kush do të ishte?-Po Petrarka kush do të ishte?-Po Sollzhenicini kush do të ishte?- E shumë të tjerë si këta.

A i ka munguar Camajt një Beatrice si e Dantes, një Laurë si e Petrarkës, një Xhoanë Duval si e Bodlerit, apo një Galoçkë si e Salvador Dalisë?- Kjo mbetet për t’u zbuluar ose për të heshtur paq!

Unë mendoj se Camaj për nga ana filozofike i përket ndërmjetësisë së “Vet-angazhimit” të Kafkës dhe rezistencës pasive të Gandit.

-Nga romani “Karpa” dua të sjellë pak fragmente të Camajt: “Shpëtuesit e pajës nacionale me vlerë artistike e dokumentare duhet të shpërblehen” “Ndërtesat e reja pa libra të lashtë dhe objekte arkeologjike e të artit brenda u ngjanin faltoreve pa simbole e shenjtore”; “Atje, na që s’domi me harrua gjithçka kemi mbjellë farnat e kujtesës, të cilat na mbijnë në parzëm”; “Shija inovatore në Karpë ka qenë gjithëherë kaq rrënjësore, saqë çdo brezni i binte moh breznisë së mëparshme, si me pas prorre mortjen midis”; “Mos të biem në ndikimin e epikës së lashtë ku poetët himnizonin për njësimin e njeriut me armën sikur të kishte lindë me të”; “Mbet shtang për një herë para gjinive të këngëtares së fuqishme, dy rrotulla buke posa dalë prej furre e kapë për faqen e hënës plotë”. Për ta mbyllë këtë ligjëratë dua të citoj një thënie të Kadesës: “Epokat dhe popujt, zakonisht nuk bëjnë gabime në vlerësimin e artit të madh. Edhe kur gabimet ndodhin, nuk janë veçse të përkohshme. Gjithmonë vjen ora kur të vonuarit mbërrijnë dhe të munguarit shfaqen. Në ngrehinën e përkorë të letrave shqipe, atje ku është duke zënë vendin e vet Martin Camaj, ashtu si në çdo panteon hyhet vetëm nga një portë, natyrisht të saj të madhes. E ajo portë, siç e tregon emri, nuk njeh veçse arsye të mëdha”.

Të nderuar miq!-Camajn e kemi përsëri midis dy kohësh!-Një kohe që i vrau jetën, por jo emrin, dhe të sotshmes që po i rrezikon kapitalin intelektual mbarëkombëtar të tij. Vërtetë se u shpall “Nderi i Kombit”, por shtëpia e tij në Temal prej 45 metrash e gjatë është rrënuar e po rrënohet dita-ditës, ajo pllakë pas derës është turp të thyhet nga kulmet e rrënuara ku një nënë malësore lindi Camajn mbi rrasa guri. Dhe në fund të fundit cilat janë vlerat që mund të ketë më tepër Muzeu Historik i Oso Kukës në raport me Camajn e dimensionit evropian?!-Nesër është shumë vonë!

SI NA GJEJNË FESTAT E MËDHA!? FESTAT E MËDHA 28-29 NANDORI, NË OPTIKEN E KOHËS

- JEMI NË KOHËN E REFLEKSIONEVE -

Duke shfletuar gazetën “Dukagjini”, tetor 2013, në faqen 2 te saje, ndeshemi me shkrimin: “Kurrë Kosova s’që Turqi-Zoti Erdogan”, shkrua nga shkrimtari dhe kritiku letrar, Kadri Ujkaj. Në këtë shkrim, ku (sipas mendimit tim) janë dhanë në mënyrë mjaft të detajuar faktet që hedhin poshtë hipotezën e Kryeministrit të Republikës Turke. Historikisht, Perandoria Osmane ma e fuqishmja e kohës, nuk erdhi për te na çliuar nga serbet, por ne fakt erdhi si pushtuese, si ne ashtu edhe serbet, greket, bullgaret, rumunet dhe një pjesë

e Evropës Qendrore patën te njëjtën fat.

Zotni Ujka, me mjaft kompetence historike sugjeron se, as sllavet, as turqit osmanllije nuk e kishin nivelin e qytetërimit në shkallën e qytetërimit Arbër. Veçse një gjë duhet theksua, për hire se vërtetës: Sllavet zbriten nga Uralet si tufa “kafshësh te uritura që ne shekullin VI dhe u vendosen në tokat ton atë pjellore si shërbëtor, dhe jo me luftë”. Pra, historikisht, kur turqit osmanllije sulmuan Ballkanin, sllavet kishin ma shumë se shtate shekuj që banonin në këto troje. Beteja e

Fushe Kosovës-qershor 1389-, ne te cilën ne koalicioni kristian ballkanas ishin rreshtuar edhe prijësit e Arbërisë: Gjon Kastrioti, Gjergj Balsha, Gjergj Araniti e te tjerë, ndonëse kjo që një beteje e humbur, gjithsesi pati heroit e vete. Asht, vërtetë për te ardhur keq, kur mendon se, Millosh Kopiliqi, biri i Drenicës legjendare, ndonëse kreu një vepër heroike duke therë Sulltan Muratin, ai nuk ka asnjë bust apo monument!? Ende ma e çuditshme asht që ne Fushe Kosove kane ndërtuar një “Faltore (Tyrbe)” me emrin e pushtuesit ma

mizor te Perandorisë Osmane-Sulltan Muratit!? ...

Do te mjaftonte ky fakt, për te justifikuar pretendimin e Erdoganit se, “Turqia asht Kosove dhe Kosova asht Turqi” ... Neve duhet te pranojmë, sado me dhimbje se, asnjë shtet ne Perandorinë Osmane nuk i dha kualitete kësaj Perandorie ne te gjitha fushat. Fakti që, që nga viti 1455 deri ne fund te shekullit XIX, ne i “dhuruam” Turqisë 28 Kryeministra (Vezirë), Rektorin e Pare te Universitetit Turk, Ideologun ma te madh te Turqisë-Sami Frashrin e sa e sa te tjerë diplomat e politikane që nga Pashko Vaso, Ismail Qemali e te tjerë, dhjetëra e dhjetëra pashallarë.

Dihet se, pasojë pa shkak nuk ka, ndonëse ne shohim vetëm pasojat. Por, me sa duket, Erdogani i njihte edhe shkaqet ...

Nuk ka deklarate ma përvese dhe



Përgatiti, Dr. Med. Ndue Nikaj

Shllaku një nga fiset me zë të malësisë për trimni, burri e besë, i treveses së shtruar për mikun (bukë e kripë e zemër të bardhë), i rakisë dhe i qymyrit.

Sipas të dhënave të trashëguara brez pas brezi dhe studimeve, zona e Shllakut dhe e Temal-Dushmanit, ku deri vonë përfshihej dhe Mazrreku me dy fise të veta (Kçyra dhe Bardhi) bëjnë pjesë në zonën e Dukagjinit, të Rreth-Qarkut Shkodër.

Shllaku ka një sipërfaqe prej 129, 32 km², ndërsa Temal-Dushmani 105, 12 km², me afro 4 200 banorë në vitet 80.

Bën pjesë në zonën tektonike të alpeve dhe të Cukalit (maja e Muleqethit me lartësi 1 721 m), ku dhe për këtë Temali merr emrin—Tej—mal (përtej malit). Zona në përgjithësi dominohet nga shkëmbej gëlqeror si dhe të tipit terrigjen duke u përfshirë në krahinën malore — veriore në pellgun ujëmbledhës të lumit Drin me dy hidrocentralet atë të Koman—Gushtë dhe të Vau—Dejës.

Të dy zonat përmbajnë toka : të kafëta, të murrme pyjore dhe kullota malore. Brezat pyjore janë të katërfishta : - drurë dhe shkurre mesdhetare

Pyjet e dushqeve (lis, bung, qarr); Ahishtat dhe—kullotat alpine.

Zona e Shllak-ut dhe e Temal—Dushmanit kanë qenë të ndarë me vete në dy krahina, në atë të Shllak-ut dhe të Temalit, me pari të veçantë.

Deri vonë Shllaku i është bashkangjitur herë Dukagjinit me qendër në Kodër të Shën Gjergjit (Shosh) dhe herë asaj të Postribës, me qendër në Mes; ndërsa Temali ka qenë gjithnjë me Dukagjinin deri në kolektivizimin e bujqësisë (përfashtua fshatin Qerret, që për afërsi ka kaluar gjithnjë me Shllakun).

Pas kolektivizimit fillimisht u përqendruan në dy kooperativa dhe më vonë

ma poshtëruese se sa ajo e Eshref Frashrit, ish Nënkretar i Parlamentit Shqiptar, kure ne vitin 1924, ne Parlamentin Turk, do te deklaronte se, “Turqia dhe Shqipëria janë një trup i vetëm ...!” Besoj se çdo koment do te ishte i tepërt. Ishte turpi dhe tradhtia ma e madhe, qe klasa feudalo-kolaboracioniste po i bënte Atdheut te Gjergj Kastriotit dhe gjakut te derdhur gjate pese shekujve.

Nuk mund te shmange rezistencën e Popullit tone dhe ne veçanti disa momente te shekullit XIX:

* Ishte viti 1830, kur Hrushid Pasha-Serasqeri i Rumelisë, fton ne Manastire te gjithë Parinë e Jugut, 500 burra, gjoja për t’ju paguar rrogat e prapambetura dhe për ti “dekoruar”, për shërbimet qe i kishin bë Perandorisë. Po, çfarë ndodhi? Por sa arritën ne Manastir u gjenden nen breshërinë

ZONA E SHLLAKUT

- DISA VEÇORI -

në një kooperativë të bashkuar, me një këshillë të Bashkuar dhe me një gjendje civile deri në vitet e rënies se komunizmit në Mes. Në vitet 80, me fillimin e punimeve për ndërtimin e Hidrocentralit të Koman-it, Shllakut iu bashkëngjiti dhe fshati Koman (deri atëherë me Pukë-n); më vonë në vitet e Demokracisë pas rrëzimit të komunizmit u krijua një Komunë e Temalit, të cilës iu bashkëngjiti fshati Toplanë dhe fshati Koman, kjo për arsye të shpërnguljes masive të popullsisë për në zonat fushore dhe deri qytete të tjera, ku popullsia është reduktuar në disa qindra vetë, sido që mbeten me pasaportizim aty.

Tani, për sa i takon origjinës, Shllaku dhe Temal—Dushmani nuk kanë asnjë lidhje as me njeri tjetrin në prejardhje dhe aq më pak me Dukagjinin e Mirditën.

moi me 100 000 trupa viset shqiptare të Veriut duke bërë kërdrinë në Ulqin, Tivar, Tuz dhe Shkodër. Në këtë kohë shumë shqiptar u larguan në vende të ndryshme dhe disa morën malet: - këtu mendohet se ka lëviz Zan (Xan) Gabeti (Vasojeviç) me të afërmit e tij—vete zuri vend në të quajturën “Ceka e Shllakut” (Mëgulla), sot e zënë nga liqeni i Vau-Dejës dhe një vëlla në Toplanë (ku dhe sot quhen ipçinë—vëllezër) dhe nuk martoheshin deri vonë, po ashtu dhe në Gash të Krasniqes: një tjetër ku dhe pse kanë kaluar shekuj nuk ka pasur martesë në mes Shllakut dhe Gashit.

Shkrimtari dhe patrioti i madh, Pashko Vasa në romanin e parë shqiptar, të botuar fillimisht në Frëngjisht, në 1882, me titull “Bardha e Temalit” midis të tjerash thekson se Shkodra në 1479, kur u



Sipas gojëdhënës, Shllaku ka ardhur nga shqiptarët e Gabetit—Kuç, që janë në Mal të zi sot, ndërsa Temali nga shqiptarët e Tuzit.

Dhe me të dhënat historike, Shkodra deri një dekadë pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, ishte nën sundimin (zotërimin) e Venedikut dhe nuk iu nënshtroa turkut. Në vitin 1479 Sulltan Mehmeti i II, sul-

sulmua nga Mehmeti i II, kishte 30 000 banorë, me zor arriti të mbledhte 16 000 ushtar dhe pas tmerrit që kaluan banorët e Shkodrës, 2/3 ishin kthyer me të gjitha format në muhamedan. Megjithatë, Sulltan Mehmeti nuk arriti të merrte kështjellën “Rozafa” dhe u tërhoq më turp me humbje të mëdha. Po në këtë vit me marrëveshje midis Perandorisë Turke

gjetur “mineralin” e mbijetesës, as gjë tjetër nuk dëgjua për pushtuesit pese shekulle Osmane! Nuk u fol për aktin madhor te Mic Sokolit, te Nores fame madhe te Kelmendit, nuk u fol për flamurtaret e Pare-Legjende e maleve, te pavdekshmin Dede Gjon Luli. U kalua si ne “hije”, Emblema e Pavarësisë-Luigj Gurakuqi e te tjerë e te tjerë.

Por, gjithsesi, historia nuk vdes, do te ishin vëllezërit e vërtetë—austriake, themeluesit e vërtetë te Shtetit Shqiptare, qe do t’na sillnin shpatën dhe përkrenaren e Heroit tone Nacional, Gjergj Kastriotit.

Na sollën nga Italia “Mesharin e Buzukut”, te paren vepër te shkruar ne gjuhen shqipe, ne atë gjuhe, te cilën pushtuesit osmane donin ta asgjësonin duke mos lejuar hapjen e shkollave shqipe për afro pese shekuj, dhe qe çuditërisht ka edhe sot prej atyre pseudo-shqiptareve, qe i quajnë turqit vëllezër te një

dhe Venedikut, Shkodra iu la Turqisë si kështjella e fundit dhe nuk ka mbetur këmbë e krishteri, por janë larguar me ndihmën e Venedikut, për në Itali dhe në vende të tjera të botës.

Ndërsa Temali, mendohet dhe shtjellohet se, është i ardhur në këtë kohë nga shqiptarët e Tuzit, i pari, i quajtur Ali Tuzi, i cili ka zënë vend në të quajturën “Toka e Qerretit”—Temal.

Analizojmë tani më imtësisht Shllakun, i cili siç do të shohim përbëhet nga katër (4) vëllezër, 3 (tre) lagje dhe fshatin Gushtë (i cili nuk ka lidhje gjaku me Shllakun).

Pra, i pari që ka zënë vend në “Ceka e Shllakut” është **Zan Gabeti (Vasojeviç)**, i cili pati një djalë **Jak Zani**, të cilit më vonë i lindin 4 (katër) djem :

Vuk Jaku—fshati—Vuk—jakaj, në qendër Shllak

Geg Jaku—Mëgulla dhe Haxhijaj—në Gegaj

Mark (Pal) Jaku—në fshatin Benë, ne te cilën ndodhej dhe Kryeparia.

Përshtoj Jaku—fshati Palaj, plus Vukaj sipërm dhe Zbuq.

Emri Shllak, mendohet se është venë në kohën kur Osman Pashë Hoti, i cili me urdhër të Hasan Pashës ishte emëruar komandant turk i malësisë së Veriut, nisi për të nënshtroar zonën dhe me qenë se, Hasan Pasha me anë të Shaban Beut, kishte vrarë dy djem nga Shllaku; njërit prej të cilëve pas plagosjes i kishte prerë kokën në Pazar të Shkodres, i quajturit Jak Kola. Familjaret e tij i zënë rrugën dhe e vrasin në të ashtu-quajturin **“Muri i Turkut”**, ku tabori turk nuk arriti kurrë më përtej dhe në atë kohë mendohet se, është quajtur nga përkthyesi sllav me fjalën **“Shllakov”**, vend me Zhur, mbetje. Pra, titullarët e taborit theksuan se, është vend me pak njerëz, ndonjë i arratisur, vetëm zhur ka, prandaj dhe sot në zonën e Shllakut ka shumë mbiemra “Shkja (Shqau)”, “Zhuri”.

Në të quajturin “Mur i Turkut” është lejuar me vendim të kuvendit të krerëve të zonës të banoj familja myslimane (nga Ura e shtrenjtë) e Isen Osmanit, e cila ka qëndruar deri më sot dhe ishte e mbetet familje e nderuar.

Ja kënga e Jak Kolës, nga Shllaku para xhelatit:

... Unë po vdes i pa fajshëm, por pa frigë, ashtu si gjithë raca ime. Po me dënon pa drejtësi e pashës, se ky, nuk i trembet kërkuj dhe sulltani është larg dhe shumë i lartë, për të

gjaku!? ... Thoni pastaj a kishte te drejte Erdogani??? ...

Për sa i përket 29 Nandorit, kjo date shënon ditën e shenjtë të çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashiste, dhe askush nuk mund ta kontestoj apo ta mohojë, pavarësisht se ky çlirim u kthye në një sundim diktatorial nga Enver Hoxha.

Ne përfundim: Uroj qe këto festa te mëdha te jene ditë e një harmonie dhe dashurie mes te gjithë shqiptareve, dhe njëkohësisht dite te një refleksioni për te gjithë spektrin politik. Jemi mësuar te dëgjojmë nga drejtuesit politike shprehjen aq tre pa gjetur: “Zoti i bekoftë Shqipërinë e shqiptaret!” Ndërsa unë, do te them: “Zoti ju ndriçoftë mendjen politikeve tanë!”

Mark Bregu

Stresi

- SEKRETET E ANTISTRESIT NË VENDE TË NDYSHME TE BOTËS -



Nga Voc Deda

Stresi shfaqet si një fenomen i veçantë tek disa njerëz që kanë shqetësime të ndryshme në sistemin nervor. Stresi studihet nga shkenca e psikologjisë sociologjisë dhe neurologjisë si fenomen që prek disa kategori të ndryshme njerëzish. Çdo person kur ka stres të vazhdueshëm duhet të vizitohet tek mjeku i cili është specialist për të dhënë kurën ose këshillat e nevojshme.

Kur shfaqet stresi?

Stresi shfaqet kryesisht në këto raste:

1. Nga pagjumësia që mund të ketë njeriu për arsye të ndryshme në momente të veçanta si dhe nga lodhja fizike e mendore, studimi e shkrimet e tepërta
2. Kur ka ngjarje të jashtëzakonshme në familje, në farefis, miqësi, shoqëri, siç janë sëmundjet e rënda nëpër spitale, aksidentet rrugore plagosje, vrasje ose vdekje të parakohshme.
3. Nga mosmarrëveshjet, grindjet, ngatërresat, zënkat rrahjet, që mund të ndodhin në familje, shoqëri, miqësi e te tjerë.
4. Nga zhurmat që mund të krijojnë krismat e armëve, kur zbrazin fishekët luftarakë, bombat e te tjerë.

5. Nga zhurmat që mund të krijojnë makineritë në fabrikë siç janë: Torrot frezat, matrapiku, guri fresible, gjeneratorët e dritave e te tjera.

6. Nga varfëria, siç është: gjendja sociale, ekonomike, banesa, ushqimi veshmbathja, shkollimi i fëmijëve e te tjera, është i pamjaftueshëm

7. Nga tradhtia bashkëshortore ne mes çifteve si bashkëshortë, kur janë të fejuar ose të dashuruar.

8. Nga xhelozia në mes çifteve si bashkëshortë, kur janë të fejuar ose të dashuruar.

9. Nga zhurma e lartë që krijojnë veglat muzikore të orkestrave të ndryshme e dixhej në dasma diskoteka etj.

10. Mosmenaxhimi vetë i pasurisë së madhe të tundshme dhe të patundshme si dhe mungesa e mjeteve financiare për ti menaxhuar ato e te tjera

Të gjitha këto probleme ndikojnë drejtpërsëdrejti tek njeriu në gjendjen morale, shpirtërore fizike e psikologjike. Prandaj kërkohet kujdes nga secili person që të evitojë kontaktet brenda mundësive me këto probleme që të mos ketë strese.

e te tjerë.

Në Nasiç (lagje e Gegaj), është strehuar për arsye gjaku familja Mar-Nikaj nga Qerreti, ku ka banuar dhe kryetari i parë i Këshillit të Shllakut, Prelë Nik Kola, një burrë i qetë e i mençur, i persekutuar nga regjimi komunist, por që mbetet një figurë e pa përljem dhe e nderuar.

Ne Bene, ka qenë strehuar herët një familje nga Mërturi (Lek Bibaj) e Ndue Luk Martin, sot e Gjelojsh Gjokës dhe e Luk Ndojës me vëllezër, të cilët janë integruar si vendasit, sido qe nuk kanë lidhje me fiset e fshatit. Dihet se Bena ka fisin e Marjakaj (tre vëllazëri (Syla, Mala e Turku). **Syla** futet shtëpia e Kryeparise, e Vat e Mark Prendushit, Ndue Mark Gjeka, e Kolë Lukës dhe e Nik Palit si dhe Mark-gjon Pjetrit, Mark Mirash Lisi, **Mala** (Kol Zef Denici–dalë fare si meshkuj), **Rrush Turku** (shtëpia e Ndue Sokolit).

Në Benë, përfshihet Shtëpia e Gjon Nushajve–Ndoc Gjelojsh Thanza dhe Hil Ndojës, ose shtëpia e Palit, ne te cilën përfshihet dhe Llesh Mark Rroku, Mhill Nika dhe Ndue Leka (Lek, Gjergj, Prek, Pjeter Ndoja–Shkambajt), Kol Gjon Nika dhe Pal Zef Nika.

Brahimaj, bëjnë pjesë Zef Kol Deda, Nik Mark Deda, Ndue Mhill Pjetri, Mark Llesh Deda.

Gushta, është një fshat me identitet nga dy fise të ardhur herët që nuk lidhen me Shllakun.

Gjon Ndreaj–të ardhur nga Reka e Gjakovës, ku përfshihen familja e madhe e Pashk e Kolë Mark Nikes, Mhill Gjergj Gjonit, Lek, Pep e Frano Ndoja e Pal Hil Gjokes e te tjerë.

Markolaj–të ardhur nga Gojan i Mirditës, ku përfshihen familjet: Ndue e Kol Mark Simoni, Pjeter Pal Nikes, Gjon Mark Gjonit; ku në vitet 80–fusha pjellore e Gushtës–hambari i Shllakut shkatërrohet plotësisht nga Ndërtimi i H/C Komanit dhe familjet transferohen në Rranxa Bushat dhe në Mal Jushit, ku sot kanë mbetur vetëm 4-5 shtëpi; pa tokë dhe disa të punësuar në punë të ndryshme në H/C Koman, por pa ndonjë përparësi.

Në Kro i Madh ka qenë dhe Mark

Sekretet e Antistresit

Në Shqipëri: Njerëzit për të larguar stresin dalin me shokë, me shoqe ose me miqtë, pinë një kafe në kafene ose në shtëpitë e njëri-tjetrit, diskutojnë për probleme që i shqetësojnë. Në disa raste dalin e bëjnë xhiro në natyrë. Ka të tjerë që shtojnë dozën e pirjes, alkoolit dhe të duhanit gjoja për të larguar stresin

Nga një studim i bërë në vitin 2009:

Në Suedi: Njerëzit kur janë në punë për të larguar stresin, në ora 10.00 dalin e pinë një kafe ose hanë një ëmbëlsirë. Të njëjtën gjë bëjnë edhe ne orën 13.00 kur janë në punë .po kështu këtë praktikë zbatojnë edhe kur janë në shtëpi për të larguar stresin.

Në Angli: Njerëzit kur janë me stresa dalin e pinë kafe. Anglezët janë më të stresuarit sepse kanë kohën e keqe, pothuajse vazhdimisht vranësira ose shira e mjegull.

Në Indi: Njerëzit kur kanë stresa bëjnë masazhe, duke fërkuar kokën, qafën, deri në tridhjetë minuta, kjo metodë çliron muskujt dhe largon stresin, kur janë në punë e praktikojnë në pushime dy tre herë në ditë, (vijon në faqe 11)

Gjon Kola, i cili jetoi 135 vjeç dhe është i dëgjuar në të gjithë zonën e Shkodres për jetëgjatësi të lartë.

Siç u përmend në fillim, Shllaku krahas katër vllaznive ka dhe tre lagje–**Kroi (Krye) Madh, Barcolla** dhe **Vasiaj**, që sipas Goje-dhanës janë nip i bijës së Shllakut të lejuar që herët të strehohen në periferi.

Nga ana etnografike, Shllaku është i ardhur nga Gabeti (afër Kuç i shqiptarëve në Mal të Zi) qe ipçin me Toplane dhe Gash të Krasniqes (për Shllakun Zan Gabeti–Vasojeviç) dhe gjithë vëllazëritë e Shllakut identifikohen tek brezi i X-XI tek Jak Zan Gabeti (Vasojeviç).

Kështu për fshatin Gegaj, nga më i riu deri në themel të fisit të Xhek Lin, Zef, Marash , Pjeter, Zef, Prend, Ndoje, Haxhi, Isen, Pap, Geg, Jak, Zan, Gabeti (Vasojeviç).

..., Hil, Nush, Nik, Pjetër, Prend, Ndoj, Ndue, Haxhi, Pap, Geg, Jak, Zan, Gabeti (Vasojeviç).

Fran, Ndue, Luk, Geg, Zef, Prend, Ndue, Haxhi, Isen, Pap, Geg, Jak, Zan, Gabeti (Vasojeviç).

Po ashtu për Benën / shtëpia e Kryeparise: Pjetër, Kol, Tom, Zef, Pal, Kol, Ndoj, Pal, Syl, Mark, Jak, Zan, Gabeti (Vasojeviç);

–Pjerin, Pashk, Gjon, Nik, Pal, Pjetër, Ded, Nac, Syl, Mark, Jak, Zan, Gabeti (Vasojeviç

Me këtë këngë janë nisur trimat (djemtë e shllakasve) në luftë, për të mbrojtur viset shqiptare: **“Djali i drejtohet Nenës”**

E po ngas por si vetima / Ku rreh topi e rreh martina / Ku luftojnë vllaznit e mi / Për emën të bukur të Shqypnisë

.....

Edhe thirri me fuqi / Lamtumirë shtëpi e bagëti / Lamtumirë malet e mia / Se me vdek më thërret Shqypnia / ...

(Marre nga Revista “Gruaja Shqiptare”, Nr. 2, me 1 gusht 1920)

ndigju e ankimet tona.

... Pasha dha urdhër të pritët koka pasi me gjuajtje me dymijë plumba nga xhandarmëria dhe me theu kamben, shoku jem pati fatin e vdiq në vend, por kështu vdesin trimat-a nga pushka a nga shpata.

... Të lutem nënë mos çaj, se unë nuk i trembem vdekjes, unë po shkoj tek të parët e mij pa mu dridh qerpiku; as ti gru, Dave mos qaj, se nuk po të la krejt, se po të la dy djem, që ti do të dish ti rritesh siç rrit shqipja zogit e vet, ky është fati jonë të vdesim nga perandoria turke, nga një vendim mizor, por mu aq më behet, unë po jap gjakun për vatan, që toka pllenohet e të lindi heroj.

... këtu po e mbyll këngën në këtë botë dhe strofën e fundit do ta këndoj para zotit, ku do t’i lutem të ketë mëshirë për vendin tem. Tashti o xhelat merre këtë monedhë argjendi e vetmja që m’ka mbetë e më dërgo sa më parë n’atë botë!...

Nga Pashko Vaso tek romani “Bardha e Temalit” (Përkthim Shqip, fq. 51-52)

Siç u theksua më lart zanafilla e Shllakut është në të quajturën “Ceka e Shllakut” në Megullë (Gegaj e njohur sot) dhe Haxhiaj, të cilët në vitet 69 u përmyt shumica nga ujërat e H/C Vau Dejës.

Vuk–Jakaj, qendra e Shllakut e Logut të Gegaj, ku janë zhvilluar kuvendet e burrave të mençur të zonës “den baba den”, për zakon e për burrni. Aty ka qenë fshati i Leqezajve (Gjon Leqejza, sot i biri Gjergji), i të quajturit Ndoc Kol Hila, sido që i ardhur më vonë aty, ka bërë histori në Vuk-Jakaj, si plak pleqërie në gjithë zonën.

Gegaj (Megulla, Haxhiaj e Nasiq), vend lindja e Gjek Gegës së Madh, një burrë i mençur, njohës i mirë i Kanunit dhe trim si zana, i burrave në zë si: Pjetër Zef Haxhija e Lek Pali, i poliglotit të njohur Gjon Shllaku, përkthyesi i “Iliadës” dhe i të vëllait Lec Shllaku, aktor i dëgjuar, “Artist Populli”, njohës i mirë i disa gjuhëve e në veçanti i gjermanishtes dhe i greqishtes se lashte, me të dy të bijtë: Primo–shkrimtar dhe Bruno Shllaku, aktor, i bur-

rave trima me zë si Gjon Marash Ndue Hila, Mhill Gjon Prendi e të tjerë.

Bena, nga vetë emri fshat i mirë me një ujë të pijshëm, qelibar i pastër kimikisht, po ashtu dhe për vaditje , ne te cilën prodhohet gjithçka për tokën që ka. Është fshati ku ka qëndruar gjithnjë Kryeparia i zonës, i madhi Ndoc Kola, Prek e Pal Zefi dhe sot Kole Tom Zefi, familje që ka vuajtur shumë gjatë regjimit komunist, me burgime, persekutime dhe pushkatim. Fshati ku ka lindur Hil Mosi–shkrimtar dhe muzikologu Shuk Shllaku. Në këtë fshat, në vitet 67-68 u ndërtua Hidrocentrali i Benës, i cili elektrifikoj gjithë zonën Shllak–Temal.

Palaj, një fshat i vogël sot (pasi ka qenë përmytur nga lumi i Benës, që i qëndron sipër). I ardhur nga Përshkoj Jaku, i cili përbëhet nga 3 (tre) vëllazëri: Gjon Palaj (Kol Osmanaj), Corraj dhe Linaj. Që në kohë të hershme janë shpërngulë në Vukaj dhe Zbuq, ku kanë vazhduar deri më sot lidhjet dhe as nuk janë martuar njëri me tjetrin ndonjëherë. Në fshatin Vukaj përfshihet dhe “Muri i Turkut” me familjen myslimane të Isen Osmanit, që është lejuar të strehohet aty me kuvend të burrave dhe ishte dhe mbetet një familje e nderuar. Po ashtu përfshihet “Firza e kuqe”, ndërsa Ukbibaj, në Zojze e Thep janë të ardhur nga Temali (Telumë e Arrë). Në Palaj afër Komanit ndodhej Miniera e Bakrit (Palaj), që në vitet e Demokracisë u mbyll plotësisht.

Zona e Shllakut ka qenë shumë mikpritëse dhe bujare, ka pranuar shumë familje të strehohen për arsye gjaku si: në Lagjen Xhanaj të Vuk – jakaj, siç u theksua–Familja e Ndoc Kol Hilës e Gjon Mark Franes; në Prroi i Lugjeve–Mark Hila (sot Hil Mark e Gjelojsh Mark Guri) dhe nipa tek daja Pjeter Gega e Ndue Mark Kumbulla në tokën e Prendush Nikës.

Në Kro i (Krye) Madh, është pranuar familja e Gjon Ndue Pukës të ardhur nga Puka.

Në Palaj, pas përmytjes, në Gegaj ka shumë familje nga Megulla të vendosura aty dhe sot e kësaj dite, si familje Lecaj, Zef e Ndoc Martini, i quajturi Hilë Shllaku

ZYDI BARBULLUSHI, KUJTIMET E MIJA PËR DODË TAHIRIN



KUSH ËSHTË ZYDI BARBULLUSHI?!

Ai ka lindur në Shkodër në vitin 1926, në Lagjen “Garuc” të Shkodrës, e cila pati traditë çiklizmin e futbollin, i cili zhvillohej rrugicave dhe potologjeve të Tophanës, ku siç kujton vete, Zydia, tashmë 85- vjeçar, mbas futbollit luhej edhe bixhoz (kumbar) prapa xhamisë së Garucve. Zydiu,ka qenë nxënësi i shkollës fillore të Tophanës, të cilën nuk e vazhdoi më tej pasi ishte plotësisht i dhënë pas lojërave sportive.

U shqua si luftëtar, pasionant pas bilardos në karambol, duke hyrë në historinë e këtij sporti si një nga stekat e vjetra historike të qytetit tonë. Ai, Loro Boriçi dhe Alfred Ashiku janë etiketuar si trashja më e mirë e kohës. Zydiu gjithë jetën mbeti aventurier i guximshëm i notit (zhytës dhe kërcimtar), të cilin e ushtroi në çdo stinë të vitit. Si sportist më pas do të lë gjurmë të pashlyera në historinë e futbollit. Qysh në vitet 1937-1938, atëherë 13 vjeçar, fillon të luajë me skuadrën e lagjes së tij përkrah Bahri Kavajës, Ramazan Podgoricës, Haki Llazanit duke milituar në radhët e shoqërive sportive “Teuta”, “Skënderbeu”, “Tigri” e të tjerë ... Në vitin 1944 (18 vjeçar) ka qenë një nga lojtarët më të rinj të “Vllaznisë”, debuton me sukses me të rriturit dhe shpallet dy herë kampion, në vitet 1945-1946. Krahas sportit shkëlqeu edhe në fushën e muzikës, i cili si fizarmonist i ka pas shokë të rrallë. Në estradën profesioniste të Shkodrës është vlerësuar si mjeshtër i këtij instrumenti dhe spektatori nuk i ka kursyer duartrokjet për interpretuesin e shkëlqyer. Ka luajtur shumë herë si solist pjesë klasike që gjithnjë janë mirëpritur nga publiku. Zydiu ka dhënë kontribut të çmuar edhe në fushën e kompozimit, firmën e të cilit mbajnë një seri këngësh për fëmijë e të rritur. Emri i tij përmendet sot, me respekt nga shumë e shumë fizarmonist të rinj të Shkodrës dhe zonave të Veriut, të cilëve u mësoi mjeshtërinë e të luajturit me ketë instrument në kurset që ka drejtuar në Shtëpinë e Pionierit e të Kulturës. Ka punuar për shumë vite si mësues i këtij instrumenti në shkollën e muzikës “Prekë Jakova”.

SI E KAM NJOHUR DHE SI E ÇMOJ DODË TAHIRIN?

Duke bashkëbiseduar me Zydi Barbullushin, për njohjet e tij me Dodë Tahirin, zbardhëm shumë kujtime të motit të shkuar që datojnë 65 vite më përpara

Kur jeni njohur me Dodë Tahirin, portierin e parë të Kombëtares Shqiptare?

Jam njohur që në vitet e okupacionit, kur Doda erdhi nga Podgorica për të luajtur futboll me “Vllazninë”. Nuk më kujtohet fiks data, por e mbaj mend shumë mirë kur erdhi dhe e gjeti ekipin tek po luante ndeshjen stërvitore (kontrolli) në dy formacione, ku të dy portat ishin të zëna dhe Doda mbeti me duar në xhepa!

Për pak çaste qëndroi duke pa me nervozizëm stërvitjen, pastaj iu drejtua Bimo Fakjes, të cilin me sa dukej e njihte më shumë se te tjerët.

- Bimo ku e kam vendin?!

Formacioni behej një ose dy ditë përpara, ky formacion me sa di unë ishte bërë në shtëpinë e Loro Boriçit.

- Ku do me shkua more Dodë, a sheh se i kemi të dy portat e zëna: - i përgjigj Bimoja.

- Doda iku i revoltuar, duke thënë: Ta dini mirë të gjithë se nuk, kam ardhë në Shkodër me mbledhë topat tuaj pas porte. Për mua qe hera e parë dhe fundit që e kam pa Dodën, jashtë formacionit, në gjitha takimet vendimtare të viteve të mëvonshme ishte titullar i formacionit të “Vllaznisë”.

Si ndodhi, me kusaret malaezë?

Doda ua beri tetë me dy kusarëve në pritë! Ka qenë vjeshta e vitit 1943 kur me ndërmjetësinë e Dodës po shkonim për të luajtur një ndeshje miqësore futbollit në Potgoricë. Unë Doda, Ernest Heklepjani, Muc Koxhjas dhe Bimo Fakja po udhëtonim, në një autoveturë të markës italiane, ishim shtrenjtë pasi makina ishte katër vendëshe, ndërsa pjesa tjetër e ekipit po vinte pas me një minibus pas nesh, pasi minibusi ishte makinë e vjetër, rruga ishte copë, copë e lëvizte shumë ngadalë. Ka qenë koha pas kapitullimit të Italisë dhe situata ishte shumë kaotike, kur kaluam dhe pasi kaluam disa kilometra në teritorin e Malit të Zi, në një kthesë rruge të pa dukshme, u gjendem krejt pa prit, ballë për ballë me tytat e armëve të dy kusarëve, të cilët duke na pandehur si italian të dezertuar, kishin dalë që të na plaçkitnin. Fillimisht na benë me shenjë të ndalonim dhe na urdhëruan të zbrisim me duart lart nga makina. Ishin dy persona me kapele të veshur gjysmë ushtarak gjysmë civilë, mustaqe kërlëshur e fytyrë pa rruar, të frikshëm nga pamja, nga zëri dhe aq më tepër nga armët që kishin në dorë. I pari zbrit nga makina Doda, i cili ishte në vendin e pare (kishte ketë privilegj se, po të rrinte pas, zinte vend për dy veta) dhe ju kujtoj kusarëve se, ishte Dodë Tairi nga Potgorica dhe se këta persona ne makine, ishin miqtë e tij që po shkonin tek ai në Cetinë, dhe se po i cenoj kush kish punë me njerëzit e tij. Fjalët e Dodës nuk u hynë fare në vesh kusarëve

ndaj njeri prej tyre, u drejtua të hapte bagazhin e makinës, kurse tjetri thirri me zë të late: zbritni shpejt dhe tytën e mashnës ia drejtoi Dodës në gjoks. Me thanë të drejtën të gjithëve na hyri tmerrri dhe menduam më të keqën, pasi ia njihnim kokën Dodës, i cili ne raste tilla nuk dite te tërhiqej, por gjithçka kaloj shpejt, si një iluzion i gabuar, pasi vigani ynë me mënyrë të rrufeshme, me dorën e majtë i’a kapi armën dhe më të djathtën i dha një shtytje katapultuese të tmerrshëm duke e fluturuar cubin me këmbë përpetetë në një grumbull poshtë rrugës. Doda pasi u be zot i armës i tha cubit tjetër - hidhe armën e mos lëviz qen bir qeni se te shutova zorrët e plansa. Cubi tjetër i tmerruar nga ç’panë sytë, holli armën dhe me zë të mekur na kërkoi ta falin se, kujtuam se mos ishit italian që po i shoqëronte ndonjë shqiptarë. Ma paçi faqen e zeze, shfryni Doda i mbushur frynë si luani kur paralizon ndonjë dre të fuqishëm. More qyqana, kur i keni hipur kalit t’marres (turpit) me dalë e me grabitë, duhet ta kishit pyetur prapanicën, u mban me ba një gja të tillë apo jo?! Doda, të dy mashinave ua hoqi fishekët, pastaj u ktheu përsëri, duke u thënë-ikni vrap dhe po qe se dilni më me grabitë vrafshi veten në to.

Si vijoi shoqëria juaj më tej?

Mua e Dodën, krahas sportit, na miqësoi shumë edhe muzika. Kur udhëtonim për të zhvilluar ndeshjet kalendarike, unë fizarmonikën e merrja kudo me vete, me të cilën luaja pjesë të ndryshme ku dhe shokët e ekipit këndonin së bashku. Dodë Tahir ka qenë kengëtar kryesor i ekipit. Ai, krahas kengëve shkodrane, këndonte gjithë pasion edhe kengët sllave, të cilave tek tuk u fuste edhe pasthirmë shqiptare. Gjithsesi Doda kishte një zë të ëmbël, të dredhur dhe sllavishten e fliste shumë rrjedhshëm pasi ishte rritur në Podgoricë.

Thuhet se Tahir për shkak të ca këngëve sllave u shoqërua për në gestapo nga gjermanët, të cilëve më pas në mënyrë spektakolare u iku duke i qëlluar me granatë. Si bashkëkohës dhe shok i tij, si qëndron e vërteta e kësaj ndodhie?

Unë si shok dhe dëshmitar okular duke u mbështetë tek kujtimet e mija, personale dhe të Ernest Helepjanit, Ndreke Gjergjit dhe Marash Hajatit, i kam kështuar një vend të veçantë në librin tim “Një jetë mes sportit dhe artit”, ku kapitullin i VII “Njerëz dhe sportistë të shkëlqyer”, e filloi me “Kujtime për Dodë Tahirin, portierin e “Vllaznisë” dhe të Kombëtares së Shqipërisë”.

Doda ka qenë njeri i shoqërisë dhe i qeftit. Në “Kafen e Madhe” në Shkodër së bashku me një shokun e tij duke pirë nga një gotë birre ia patën filluar një kengë sllave (Kasam sinoq), një prej lirikave të tij, të preferuara. Ky lokal frekuentohej nga gjermanët dhe kosovarët e gestapos.

Kosovarët e pandehën Dodën si jugosllav (komunist) dhe e paditën tek gjermanët, të cilët në mënyrë të menjëhershme e kontrolluan, i morën një pistoletë dhe

e nisën për në Gestapo. Doda kishte një pistoletë tjetër dhe një granatë të fshehur mirë në trup. Kur dolën në rrugë nxori granatën, ua hodhi gjermanëve, të cilët i plagosi dhe çau e iku duke kaluar lumin e Kirit te harlisur nga ujërat e vjeshtës. Nga ciflat e granatës, Doda u plagos lehtë, por nuk e ndali turrin deri në Dukagjin.

Doda ishte një trim i madh, i pa shoq. Gjesti i tij flet vetë dhe çdo koment tjetër është i tepërt. Si njeri ishte burrë i vërtetë shqiptar, të cilin kurrë nuk e kam dëgjuar të mburrej për këtë trimëri të pashoqe.

Ju dhe Xhelal Juka jeni të vetmit bashkëkohës të mbetur gjallë nga “Vllaznia” e viteve 1945-1946. Cili ishte profili i portierit Dodë Tahiri sipas Zydi Barbullushit?

Të përshkruash fizikun e tij nuk mund të gjeshe fjalë apo epitete tjetër më të përpiktë, se fjalën vigan. Kur ai vendosej në mes të kuadratit, portën e bllokonte si lisi me rrema ... Si portier flasin faktet për kohën që luajti në arenën e kampionatit shqiptar.

Ai ishte emri i parë i Shqipërisë. Doda ka lënë gjurmë të pashlyera edhe tek “Cetina”, “Buduçnosti” e “Hajduku”, madje dhe ka arritë të luajë edhe për ngjyrat e kombëtares malazeze. Nuk pati karrierë të gjatë sportive, pasi baticat dhe zbaticat e jetës nuk ia lejuan një gjë të tillë. Tahir do kujtohet si kampion që pushtoi majat më të larta të sportit shqiptar dhe korri të gjitha trofetë më të rëndësishme të stinës së tij sportive. Doda ka qenë edhe atlet i mirë, madje në hedhje gjyle pati zënë vendin e parë në rang kombëtar, ndërsa është shquar edhe si vrapues i mirë, më i shpejti futbollist i “Vllanisë” dhe i dyti në radhët e ekipit kombëtar, ku vetëm Skënder Begeja ia kalonte, pasi ky ka qenë atlet.

Dodë Tahir mund të ishte bërë edhe një mundës i frikshëm, pasi kishte fuqi sa dy-tre burra të zakonshëm dhe askush nuk guxonte të matej me të. Pasionet i tij kanë qenë edhe bilardoja e në mënyrë të veçantë noti.

Si portier është shquar në lojën në ajër dhe ka dalë kurdoherë fitimtar në duelet ajrore me kundërshtarët. Edhe sulmuesit më shtatlartë dhe me kërcyeshmëri më të lartë përpara Dodës dukeshin si ushtarët përpara portës. Doda kishte krijuar mitin e portierit të pathyeshëm në Shqipëri, plot 900 minuta pa pësuar gol!

A ju kujtohet si u thirr Doda në Kombëtare?

Përpara Ballkaniadës së vitit 1946, Ljubica Broçiç, trajneri i mirënjohur jugosllav, mori detyrën e rendësishme të seleksionimit të ekipit tonë kombëtar, që u formua nga bashkimi harmonik i dy klubeve më të mira të vendit tonë “Vllaznia” dhe “Tirana”. Doda, duke qenë portier i skuadër kampione, kishte disa rekorde absolute për kohën 900 minuta pa pësuar gol në vitin 1945 dhe vetëm pesë gola të pësuar në dy kampionatet, fituese 1945 e 1946. Broçiç, Dodën e kishte njohur që kur ky kishte luajtur në Jugosllavi, prandaj i be-soj vendin e portës në kombëtares.

Duke qenë folës i mirë i sllavishtes, Doda shpesh herë ka bërë edhe punën e dragomanit (përkthyesit) në komunikimet që bënte Broçiç me lojtarët tonë gjatë seancave stërvitore.

Prelë Millani

(vijon në numrin e ardhshëm)

Festa Nacionale e Austrisë

Me datën 15 nëntor 2013, ne mjesditet e Hotel “Turizmi” u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja dhe Natalja Leqeja si dhe Ambasadori i Austrisë në Tirane, Tomas Schnoll me bashkëshorten e tij, Regan Schnoll.

Morën pjesë Presidenti i Miqësisë Shqipëri-Austri, profesor doktor Mahir Hoti, deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore në qytetin e Qarkun Shkodër, Monsinor Angelo Massafro, Mjeshtri Fadil Kraja e personalitete të tjera në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të qytetit tone.

Pasi, u ekzekutuan Himni i Republikës së Austrisë dhe i Republikës së Shqipërisë, Fjalën e rastit e mbajti, Konsulli i Nderit, Gjergj Leqeja, i cili në mes të tjerave theksoi: “Festa e sivjetshme për të cilën jemi mbledhë vjen mbas një viti plot me aktivitete me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, feste e cila u kremtue me shumë madhështi nga i gjithë kombi Shqiptar, ku u evidendue e konfirmue roli i pazëvendësueshëm i austro-Hungarisë së asaj kohe në procesin historik të Shpalljes së Pavarme të Shqipërisë, me 28 Nandor 1912.

Ky rol i padiskutueshëm është vetëm një pjesë e historisë së lidhjeve midis dy popujve e vendeve tona që zënë fill vitet e para të shekullit 18 (me Kultprotektorat sipas traktatit të paqes së Karlovcit në vitin 1699) e që janë të shumta e gjithanshme, shpirtërore, kulturore, shkencore politike e ekonomike dhe kanë ardhë duke e fuqizuar nga viti në vit ...

Mjafton të përmendim rolin e studiuesve të shumë të albanologjisë, historisë, arsimit e shkencës së asaj kohe si Gustav Meyer, Norbert Jockli, Johann Gorge Von Hann, Baron Fon Nopca, Maksimilian Lambertz ... etj etj, mjafton të shohim në monitor pas pak minutash fotografite nga Marubi të Konsullit Austriak në Shkodër Adolf Ritter von ZAMBAUERi, cili shoqërohej nga fotografi i madh në të gjitha udhëtimet e tij edhe jashtë vendit, dhe e të shohim realitetin e sotëm të lidhjeve e projekteve të përbashkëta ndërmjet universiteteve të Vjenës, Gracit e Klagenfurtit të Universitetit të Shkodres të themeluara nga miku i madh Walter Hofleschner (i cili bashke me të tjerë si prof. Konrad, prof./Sixl, Mayerhofer, Irgolic, Schuster, Portmann, Steinbauer ... etj kontribuan aq shumë në realizimin e mjaft projekteve midis Universitetit të Shkodres e atij të Gracit në të gjitha drejtimet akademike, shkencore e financiare duke u finalizua me shumë doktoratura të studenteve shkodrane në Austri...) tregon që lidhjet shpirtërore, kulturore e me gjere midis dy popujve e vendeve po fuqizohen dita –ditës ... Sidomos do të veçoja këtu shtimin e numrit të nxënësve të shkollës profesionale “Peter Mahringer” nga e cila sivjet përfundoi studimet matura e pare ..e që me shumë kënaqësi vëmë re që një pjesë e mire e tyre ka fitua të drejtën

për të vazhduar studimet Universitare në Austri e pse jo dhe në vendet e tjera të botes ... apo për tu përfshirë me sukses në tregun e punës...

Jemi mbledhë sot mbas një sere aktiviteteve të zhvilluara me shumë sukses nga Shoqatat e miqësisë Austri–Shqipëri e Shqipëri–Austri, në Shkodër

H/C të kaskades së Drinit ku pjesëmarrja e Qeverisë Austriake nepermjet organizatave të specializuara ka qenë shumë e rendesishme për sa i përket hartimit e financimit të projekteve. Në sektorin financiar ...Raiffeissen Bankë është një nder me kryesoret në tregun bankar...Uniqa e Vjena Insurance Group janë kompanitë kryesore në tregun e sigurimeve në vendin tone...projektet në fushën e arsimit ndërmjet Universiteteve të Gracit, Klagenfurtit e Vjenës me Universitetin e Shkodres....projektishume ambicioz i shkollës “Eter Mahringer” i



Ambasadori i Republikës së Austrisë në Tirane, Tomas Schnoll



Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja

e sidomos në veriun e Shqipërisë me kryeqendër Shkodren...Ja vlen të përmendim këtu projektet në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm që fale tyre Shkodra me rrethinat janë ndoshta të vetmit që kanë të zgjidhur furnizimin me ujë që se fundmi po plotësohet dhe me projektet në përpunimit të ujërave të zeza duke ndikue në mbrojtjen e ambientit, projektet në rehabilitimin e

emër të Konsullatës së nderit, në emër të Ambasadës ... dhe timin personal dhe ju uroj çdo të mire për ju e familjet tuaja ... Edhe një here gëzuar ... Festen e Austrisë!” Përhëndeti dhe Ambasadori i Republikës së Austrisë në Tirane, Tomas Schnoll. Pastaj u dha një koketejl për pjesëmarrësit dhe vijoje festa në grupe-grupe.

REDAKSIA

Stresi

- SEKRETET E ANTISTRESIT NË VENDE TË NDYSHME TË BOTËS -

(vijon nga faqe 9)

por të njëjtën gjë bëjnë edhe në shtëpi. E kanë kulturën e tyre.

Në Zvicër: Njerëzit për të larguar stresin kur janë në punë në ora 10.00 gjatë pushimit ose pasi të lënë punën dalin e luajnë pingpong. Kjo metodë ndikon në largimin e mërzisë së stresit, të lodhjes fizike e mendore, me zënkat me shefa (eporët) për probleme të ndryshme. Kjo normalizon sistemin nervor, shkathtëson të gjithë muskujt e trupit të njeriut dhe shkojnë më të qetë në shtëpi, të njëjtën gjë bëjnë edhe në shtëpi

Në Japoni: Njerëzit për të larguar stresin si në shtëpi edhe kur janë në punë heqin këpucët e rrinë në shapka (pantofla), që këto mos ti bezdisin në punë e në zyrë ose në procese të tjera pune kjo është metoda e menaxhimit të stresit në Japoni .

Finlandezët: Njerëzit atje për të larguar stresin bëjnë banja me ujë ose me avuj të ngrohtë. Në punë kanë kushet për tu larë në kapanone të mëdha shumë punëtorë përnjëherësh. Këtë dush e bëjnë kur lënë punën para se shkojnë në shtëpi. Kjo metodë do të çlirojë muskujt të lehtësojë trupin të largojë lodhjen, stresin të jep energji të reja. Kështu veprojnë edhe kur janë në shtëpi. Këto janë populli më i lumtur në botë, sepse kanë standardin më të lartë të jetesës. Finlanda është vend i ftohtë , me klimë të ashpër, e kanë të domosdoshme larjen në banja e dushe për të larguar stresin.

Në Afrikën perëndimore:

Mënyra, metoda me e mirë për të larguar stresin është: me u bashku në grupe dhe me i ra daulteve. Kjo metodë përdoret në 16 (gjashtëmbëdhjetë) shtete afrikane. E kalojnë stresin duke dëgjuar krismat daulteve, e ritmeve muzikore, kërcëjnë, këndojnë, vallëzojnë, bëjnë shaka me njëri-tjetrin, e kalojnë me alegori. Kjo metodë u jep dinamizëm, energji, të reja dhe ju largon stresin. Këtë metodë e përdorin edhe në për shtëpia.

Përfundimi:

Përveç 10 fakteve që shikua më parë stresi vjen edhe nga lodhja e tepërt, jashtë masës sidomos në disa profesione të veçanta siç janë: shoferë, mjekët, e të tjera profesione në sektorin e bujqësisë, të ndërtimit e të tjera ...

Në largimin e stresit ndikon:

1. Leximi i librave artistikë, romaneve, tregimet novelat poezitë etj...

2. Dëgjimi i muzikë as që preferon, siç është muzika e lehtë, muzika popullore, folklorike e të tjera. si dhe shëtitja në natyrë ku ka gjelbërim e të tjera.

3. Kryesorja është komunikimi me njerëzit e dashur të familjes, me shokë e shoqe dhe miq që u beson për të diskutuar me to problemet që të shqetësojnë si dhe për të marrë këshillat e tyre.



Që prej 2-3 viteve shoqata Ambadorët e Paqes iu bashkua një grup shoqatash të ndryshme, në Shkoder me karakter humanitar, të cilët operojnë në fusha të ndryshme sociale. Dhe fal disa takimeve formuese dhe sensibilizuese, kërkuam që ne si shoqata të grupohehemi, ne grupimin “Aleanca për Jetën”. Ku takimet, aktivitetet, tryezat e rrumbullakëta, ma-

Ambadorëve të Paqës në Baqel, Lezhë. Një ditë mes miqsh dhe kolegësh në Blinisht dhe në Baqel duke vizituar bukuritë e asaj zone që mbarte mbi vete në shekuj. Si fillim ndalesa e pare ishte në Blinisht, ku aty nisi çdo gjë nga Don Antonio, që u nda nga jeta një vit më parë. Njeriu që ka ditur gjithmonë që ëndrrën ta bëjë realitet. I quajtur ndryshe, njeriu i ëndrrave



Takimi i grupimit “Aleanca për Jetën”

nisfestimet e te tjera ... kanë qënë dhe do të jenë pjesë e angazhimit tonë si grupim “Aleanca për jetën”. Qëllimi më i fortë që na ka shtyrë që të bëhemi pjesë e Alencës për Jetën, ka qënë fenomeni i gjakmarrjes plagë e vjetër e shoqërisë shiptarëve, por shumë prezent edhe në ditët e sotme.

Takimin e radhës të grupimit “Aleanca për Jetën” e zhvilluam në Qendrën e

MREKULLITE E NATYRËS

Ketë vend te bukur, natyra e ka pajis,
me gjithë bukurit e saj e ka stolise.

Si ketë vend te bekuar siç e quan Naimi,
nuk e ka bota as gjithë rruzullimi.

Me livadhe, me shume lule e me ara,
me gurra, përroi dhe ujë vara.

Ketë vend te bukur, qe Zoti na ka fale,
ta duam me shpirt e me dashuri te zjarrte.

Por gjeja me e mire e këtij vendi,
janë te rinj e te reja dhe burra vigan.

Gra dhe burra, te rinj e te vjetër,
si ne ketë vend nuk gjene askund tjetër.

NDUE MICI



+

Misioni i Blinishtit përbëhet prej 6 fshatrave: Blinisht, Gjader, Baqel, Piraj, Kodhel dhe Krajen. Me anë të bashkëpunëtorëve, miqëve, dhe personave vullnetmirë që don Antonio ka njohur është bërë e mundur që në cdo fshat të ndërtohen kisha dhe bashkë më ta edhe qendra të ndryshme sociale, edukative, shëndetsore dhe që sot të gjitha këto janë në shërbim të komunitetit. Me iniciativat, aktivitetet dhe ndërtimin e kishës së Martive të Shenjtë Shqiptar, Blinisht, çdo imazhë, simbol, monument që janë të vendosura në këtë kishë janë në harmoni me njëra-tjetren. Pas të gjitha këtyre veprave të mëdha që u realizuan gjatë këtyre viteve brenda Misionit të Blinisht lindi dhe historia e Ambasadorëve të Paqes, e cila filloi në vitin 1997, kur Shqipëria po jetonte momente të vështira e dramatike. Një grup fëmijesh nga Zadrima, të nxitur nga edukatorët e tyre, moren një iniciativë që kurrë nuk do të kishin menduar se do t'i çonte në diçka kaq të madhe: Vëndosen të mbledhnin nëpër rrugë të gjitha gëzhojat e fishekeve te dala nga armet të shprazura në menyrrë të papërgjegjshme nga të rriturit. Mbledhen me mijëra gëzhoja më të vetmën ide të PASTRONIN FSHAT-TRAT nga shenjat e vdekjes. Vetëm, me pas lindi idea të realizonin, me gëzhojat e mbledhura, një KEMBANE që të tingellonte nota paqeje në të gjithë botën! Sot ajo këmbanë, pasi udhëtoi në shumë qytete italiane, gati të gjitha qytetet e Shqipërisë e të Kosovës, gjëndet në qendër të kryeqytetit, për t'u kujtuar të gjithëve angazhimin për paqe. Nga kjo nismë e jashtë zakonshme dhe e vetme, lindi shoqata “Ambasadorët e Paqes”.

Shoqata u drejtohet në mënyrë të vecante të rinjve, që janë protagonistët e saj të parë, ku ka lindur nga ato angazhimi i vazhdueshëm për të qënë zë i paqes, i drejtësisë. Të rinjtë pikërisht për fantazinë e tyre, të pafundme për paqe, janë MISIONARET më të mirë të vlerave të paqes. Ata takohen jave per jave dhe nga takimet e formimit, specifike per to, buron angazhimi i tyre për të qënë përcues të mesazhit të paqes. I kemi quajtur, “Ambasadorët e Paqes”, sepse angazhimi i tyre i pare, është të shkojnë nëpër shkolla, për të sensibilizuar moshatarët e tyre, veçanërisht për problemet, që i përkasin fëmijëve të botës: JO shfrytëzim! JO gjakmarrje!



Simbol i Bashkejteses fetare



Vendi symbol i kujtimit te vajzave te humbura të Zadrimës

JO analfabetizëm! Paqe, Paqe deh ditori! ...

Pas ndalesës që bëmë në Blinisht u nisëm drejt Baqlit aty ku është dhe qendra e Ambasadoreve të Paqes dhe ku takimin tonë të radhës, qe shoqata e grupimit “Aleanca për Jetën” e zhvilluam në këto ambiente.

Sander Vlashaj, administratori i shoqatës “Ambasadorët e Paqës”,
Valbona Kini, edukatore e shoqatës “Ambasadorët e Paqës”.

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

+